



USHTRIA



Viti i 74-të i botimit Nr. 48 (827746)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 26 Nëntor 2021

Kursi i Stërvitjes Individuale Bazë, në Bunavi



Kolonel Neziri: Dijet dhe aftësitë e fituara do t'ju shërbejnë për të rritur më tej profesionalizmin gjatë kryerjes së detyrave në repartet e FA-së

Përfundoi kursi i Stërvitjes Individuale Bazë, në Bunavi. Në mjediset e Qendrës së Arsimit Profesional të Ushtarakëve, Bunavi, Vlorë, u zhvillua ceremonia e certifikimit dhe betimit të rekrutëve të rinj, të cilët përfunduan kursin e Stërvitjes Individuale Bazë. Në këtë ceremoni mori pjesë zëvendëssekretari i AFA-së, kolonel

Fatmir Neziri. Në fjalën e tij përshëndetëse zëvendëssekretari theksoi: "Ju shpreh mirënjohjen time për përkushtimin dhe seriozitetin e treguar për atë që ju reflektuat gjatë stërvitjes këtu në Bunavi. Jam i sigurt se dijet dhe aftësitë e fituara do t'ju shërbejnë për të rritur më tej profesionalizmin gjatë..."

» faqe 2

Konferenca Shkencore "Mjedisi dhe Sfidat e Sigurisë"

Ministri Peleshi: Aleanca jonë duhet të jetë gati sot, për t'u përballur me sfidat e së nesërme

Ministri i Mbrojtjes: "Aleanca jonë duhet të jetë gati sot, për t'u përballur me sfidat e së nesërme", "NATO 2030" platforma jonë e përbashkët » faqe 3



Arma e Kimisë 68 vite histori, përkushtim, zhvillim shkencor

Intervistë me Drejtorin e Laboratorit Qendror të FA, nënkolonel Dod Vukaj



» faqe 6-7

Akademia e Forcave të Armatosura

Zhvillohet procesi i përzgjedhjes së nënoficerit të vitit 2021 në AFA

Në kuadrin e përzgjedhjes së "Nënoficerit të vitit në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", në Akademinë e Forcave të Armatosura, u zhvillua procesi i përzgjedhjes së nënoficerit më të mirë për vitin 2021. Në këtë proces konkurrimi, që u zhvillua në dy faza, morën pjesë të gjithë nënoficerët me gradën N/tetar-Rreshter që shërbejnë në AFA si dhe në institucionet vartëse të saj. Duke iu...



» faqe 6

Të drejtat

Diskriminimi në punë si burim i urrejtjes

Shumë njerëz vuajnë pasojat e shprehjeve të urrejtjes apo diskriminimit. Me siguri se, sikur të mos ekzistonte urrejtja në njeriun ndaj njeriut apo e njerëzve ndaj njerëzve, jeta do të ishte më e lumtur për të gjithë. Pra, sikur të mos ekzistonte urrejtja, nuk do të kishim as një lloj diskriminimi. Që të dyja kanë bashkëjetuar, bashkëjetojnë e do të bashkëjetojnë, si dhe që të dyja i kanë shkaktuar, i shkaktajnë dhe do t'i shkaktajnë vuajtje njerëzimit. Ngarkesa e organizmit të njeriut me energji negative...

» faqe 5



Rikonfirmim i unitetit të Aleancës përballë sfidave të sigurisë

Stoltenberg: Gjermania ka një përgjegjësi të veçantë për ta mbajtur NATO-n të fortë

» faqe 9

CEREMONIA

Përfundon Kursi i Stërvitjes Individuale Bazë në Forcën Tokësore

» faqe 2

SKËNDERBEGASIT

Nga fusha e blertë në ring, Partizani 'ylli' që shndrin

» faqe 10



Kursi i Stërvitjes Individuale Bazë, në Bunavi

Përfundoi kursi i Stërvitjes Individuale Bazë, në Bunavi. Në mjediset e Qendrës së Arsimit Profesional të Ush-tarakëve, Bunavi, Vlorë, u zhvillua ceremonia e certifikimit dhe betimit të rekrutëve të rinj, të cilët përfunduan kursin e Stërvitjes Individuale Bazë.

Në këtë ceremoni mori pjesë zëvendëssekretari i AFA-së, kolonel Fatmir Neziri.

Në fjalën e tij përshëndetëse z zëvendëssekretari theksoi:

“Ju shpreh mirënjohjen time për përkushtimin dhe seriozitetin e treguar për atë që ju reflektuat gjatë stërvitjes këtu në Bunavi. Jam i sigurt se dijet dhe aftësitë e fituara do t’ju shërbejnë për të rritur më tej profesionalizmin gjatë kryerjes së detyrave në repartet e FA-së, ku ju do të shërbeni. Dita e sotme është e veçantë për ju, pasi do të betoheni si ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Ju do të betoheni para flamurit tonë kombëtar, për t’i qëndruar besnik atdheut, detyrës dhe ligjit”.

Në këtë kurs u certifikuan 129 rekrutë të rinj e të reja të cilët tashmë janë pjesë e strukturave të FA-së.

Kolonel Neziri: Dijet dhe aftësitë e fituara do t’ju shërbejnë për të rritur më tej profesionalizmin gjatë kryerjes së detyrave në repartet e FA-së

Zëvendëssekretari i AFA-së: Dita e sotme është e veçantë për ju, pasi do të betoheni si ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë



Përfundon Kursi i Stërvitjes Individuale Bazë në Forcën Tokësore

Në ambientet e Batalionit të I-rë dhe të Batalionit të III-të të Këmbësorisë së Forcës Tokësore, u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit të Stërvitjes Individuale Bazë.

Kursi, i cili filloi në datën 16 shtator, u zhvillua në mjediset dhe poligonet stërvitore nga efektivi të katër batalioneve. Në këtë kurs u trajnuan 67 rekrutë të rinj, ku një pjesë e konsiderueshme do të jenë pjesë e strukturës së Forcës Tokësore.

Programi stërvitor i këtij kursi u zhvillua në zbatim të protokollit anti - COVID 19.

Përgjatë nëntë javëve, rekrutët u trajnuan me intensitet të lartë, duke u njohur me të gjitha rregullat e jetës ushtarake duke i kthyer ata nga qytetarë të thjeshtë në efektivi të mirë përgatitur dhe të mirë trajnuar. Eksperienca dhe profesionalizmi i treguar nga trupa e instruktorëve në të dy batalionet bëri të mundur përfundimin e këtij kursi me sukses.

Forca Tokësore do të japë kontributin e saj në edukimin e brezit të ri të rekrutëve duke dhënë përvojën e saj të fituar në misione dhe trajnime.



Uzhvillua Konferenca Shkencore “Mjedisi dhe Sfidat e Sigurisë – Roli i Shqipërisë si Faktor Orientues në Ballkanin Perëndimor”. Në hapjen e konferencës, Komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, Gjeneral Brigade Albert Mullai, falënderoi qeverinë shqiptare dhe ministrin e mbrojtjes z. Peleshi për mbështetjen maksimale ndaj Forcave të Armatosura, si dhe përfshirjen e tyre ndaj sigurisë dhe mbrojtjes si një çështje me mjaft interes.

Objekti kryesor i konferencës ishte analiza e mjedisit të sigurisë dhe rreziqeve e kërcënimeve, veçanërisht atyre jo tradicionale për sigurinë kombëtare dhe rajonale, nevoja për qasje dhe reagime të përbashkëta ndaj këtyre rreziqeve, si dhe roli i Shqipërisë dhe faktorit shqiptar në sigurinë dhe stabilitetin e rajonit tonë.

I pranishëm në këtë konferencë ishte edhe ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, i cili në fjalën e tij përgëzoi organizatorët e kësaj konference si Institutin e Kërkimeve Shkencore Ushtarake dhe Akademinë e Forcave të Armatosura si institucione që po kalojnë nëpër një proces të thellë transformimi dhe riorganizimi, duke iu qasur modeleve më të mira.

Si një vend anëtar i NATOS, por edhe gjeografikisht i vendosur në qendër të këtij rajoni me shumë dinamikë në kuptim edhe të sfidave të sigurisë, kemi për detyrë të ecim me ritmet e aleancës nën platformën “NATO 2030”.

“Bota sot po përjeton një situatë komplekse të mbushur me sfida, kërcënime e rreziqe, të cilat kanë impakt mbi të gjithë shtetet dhe natyrisht kërkojnë një përgjigje të përbashkët. Në këtë kontekst, adresimi i këtyre sfidave në mënyrë thelbësore, analiza e tyre, shkaqet e faktorët, burimet e aktorët, nxjerrin si detyrim më së pari një analizë të thellë e shumëplanëshe. Mesazhi kryesor që na dha Samiti i Brukselit, është përfshirja e të gjithë aktorëve dhe faktorëve në hartimin e politikave për të ardhmen. Problemet e sigurisë dhe të mbrojtjes, nuk mund të jenë detyrë vetëm për ushtarakët. Motoja e “NATO 2030” është: “Aleanca jonë duhet të jetë gati sot, për t’u përballur me sfidat e së nesërme”, - u shpreh ministri Peleshi.

Z. Peleshi tha se objektivi kryesor i qeverisë shqiptare në fushën e mbrojtjes është mbrojtja e interesave kombëtare, parandalimi i konflikteve dhe kontributi për stabilitetin rajonal e më gjerë. Ai u ndal te lufta kibernetike, ku përmendi edhe faktin se pas pak javësh Ministria e Mbrojtjes do të marrë një rol shumë të rëndësishëm kombëtar sa i përket sistemeve të mbrojtjes kibernetike.



Konferenca Shkencore “Mjedisi dhe Sfidat e Sigurisë”

Ministri Peleshi: Aleanca jonë duhet të jetë gati sot, për t’u përballur me sfidat e së nesërme

Ministri i Mbrojtjes: “Aleanca jonë duhet të jetë gati sot, për t’u përballur me sfidat e së nesërme”, “NATO 2030” platforma jonë e përbashkët



“Jo vetëm në raport me sistemet ushtarake, por në bazë të vullnetit politik, ne do të jemi institucioni qendror i politikave, rregullave, standardeve të mbrojtjes kibernetike, jo vetëm për hapësirën e sigurisë dhe mbrojtjes ushtarake, por edhe për të gjithë sistemet e tjera të infrastrukturës kritike, qofshin këto civile apo private. Ne jemi duke zhvilluar një projekt, së

shpejti do ta jetësojmë në partneritet me aleatin tonë strategjik SHBA, për sistemin e mbrojtjes kibernetike të sistemeve tona ushtarake, por nga ana tjetër në këtë fushë përgjegjësie ne do të ngremë kapacitetet për të hartuar politika, rregulla, standarde të detyrueshme për t’u zbatuar nga të gjitha institucionet publike dhe private që i përkasin infrastrukturës kritike”, - u shpreh ministri Peleshi.



“Objektivi kryesor i qeverisë shqiptare në fushën e mbrojtjes është mbrojtja e interesave kombëtare, parandalimi i konflikteve dhe kontributi për stabilitetin rajonal e më gjerë”.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi: Populli shqiptar qëndron pranë vëllezërve dhe motrave tona në këto çaste sa tragjike aq dhe të vështira

Të paktën 46 persona, shumica prej tyre nga Maqedonia e Veriut, raportohet se kanë vdekur pasi një autobus është përfshirë nga flakët në një autostradë në perëndim të Bullgarisë. Mediat raportojnë se në mesin e të vdekurve ka edhe fëmijë, ndërkaq aksidenti ka ndodhur në autostradën Struma rreth 45 kilometra në perëndim të Sofjes.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi: “I tmerrshëm lajmi për vdekjen e 45 qytetarëve të Maqedonisë së Veriut në Bullgari. Ngushëllime familjeve të viktimave, shërim të shpejtë të plagosurve. Populli shqiptar qëndron pranë vëllezërve dhe motrave tona në këto çaste sa tragjike aq dhe të vështira”.



AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA

Zhvillohet procesi i përzgjedhjes së nënoficerit të vitit 2021 në AFA

Nënoficeri i vitit 2021 në AFA, Tetar Marlind Ceka efektiv i QAPN-së

Në kuadrin e përzgjedhjes së “Nënoficerit të vitit në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, në Akademinë e Forcave të Armatosura, u zhvillua procesi i përzgjedhjes së nënoficerit më të mirë për vitin 2021.

Në këtë proces konkurrimi, që u zhvillua në dy faza, morën pjesë të gjithë nënoficerët me gradën N/tetar-Rreshter që shërbejnë në AFA si dhe në institucionet vartëse të saj.

Duke iu referuar testimeve dhe rezultateve përfundimtare sipas listë-meritës, bordi qendror i ngritur për këtë qëllim shpalli nënoficerin e vitit 2021 në AFA, Tetar Marlind Ceka efektiv i QAPN-së, vendin e dytë e zuri Nëntetar Shkëlqim Ferati efektiv i QAPN-së dhe vendin e tretë e zuri Tetar Besnik Nilo, efektiv i QAPU-së.

Nënoficerët e lartpërmendur të cilët u renditën në vendin e parë, të dytë dhe të tretë iu jepet e drejta për të vazhduar këtë garë për nënoficerin më të mirë të vitit 2021, në Forcat e Armatosura.



Pavilioni “Syri i qiellit” në përkujtim të 23 personave që humbën jetën

32 vite më parë, më 22 nëntor 1989, ndodhi e para ngjarje e kronikës së zezë që kapërceu kufijtë shtetërorë të ish-Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, ku në një aksident tragjik, humbën jetën 23 persona, ndër ta shumica studentë të Institutit të Lartë Bujqësor.

Autobusi po kthehej nga një ekskursion në jug dhe gjatë rrugës, për shkak të një problemi në sistemin e frenimit, automjeti rrëzohet në humerë. Në atë kohë, Ministria e Brendshme dërgon dy helikopterë për të shpëtuar jetët e studentëve, për shkak të kushteve tejet të rëndura të motit, edhe këta helikopterë që transportonin jetët e studentëve u rrëzuan... përkatësisht në Vuno e Llogara. Në orën 18:20 është nisur për fluturim helikopteri i drejtuar nga Agron Galanxhi, duke marrë drejtimin e bregut të detit. Pas tre minutash është ngritur për fluturim helikopteri i drejtuar nga Vangjel Postoli, i cili fillimisht mori drejtimin për nga Saranda, pastaj kthehet dhe merr drejtimin e fshatit Vuno, duke bërë një fluturim të çorientuar, ndryshe nga kursi i kthimit. Rreth orës 19:00 është përplasur me malin mbi Vuno, duke shkaktuar vdekjen e të gjithë personave që ishin në të si dhe shkatërrimin e plotë të helikopterit. Po rreth kësaj ore, nga një repart ushtarak në afërsi të Llogarasë është dëgjuar një e përplasur e forte në shpatin e malit, e shoqëruar me një flake të madhe. Nga kërkimet e bëra pas 14 orëve, në datën 23.11.1989, në këtë vend u gjetën helikopteri i shkatërruar plotësisht dhe të gjithë

personat që ishin në të, të vdekur.

Nga përplasia e tyre gjetën vdekjen 23 persona.

Heroizmi është vetëm një çast. Dikush e pikas dhe e përjeton atë, të tjerët e mësojnë nga të parët dhe e çmojnë atë, në mënyra nga më të ndryshmet; sipas pozicionit të tyre, shkallës së njohjes dhe interesave, nivelit dhe raportit me protagonistin. Dimë se një akt heroik nuk ndodh as rastësisht e nuk mund të ngajë vetiu. Ai përgatitet “në fshetësi” e akumulohet si grumbullim i brendshëm, në thellësitë e qenies së një njeriu e shpërthen, kur t’i vijë koha ose kur kërkohet. Pavarësisht nga motivi (motivet) që e shtyn, apo nga përmasat e shfaqjes së tij, akti heroik, në varësi nga rrethanat dhe mjedisi ku ngjan, vjen me shumë bujë e shkakton pështjellime në mendjet e të pranishmëve.

Pilotët që humbën jetën, Dëshmorë të Atdheut:

Vangjel Postoli, zv./komandant regjimenti,
Agron Galanxh, Komandant ekuipazhi,
Tafil Agaj, Komisar skuadrilje,
Veledin Resuli, Komandant ekuipazhi,
Pandeli Xhumba, Teknik helikopteri,
Enver Haka, Teknik helikopteri.

Për nder të këtyre viktimave, u inaugurua Pavilioni “Syri i Qiellit” në zonën e Liqenit Artificial.



Diskriminimi në punë si burim i urrejtjes

Shumë njerëz vuajnë pasojat e shprehjeve të urrejtjes apo diskriminimit. Me siguri se, sikur të mos ekzistonte urrejtja në njeriun ndaj njeriut apo e njerëzve ndaj njerëzve, jeta do të ishte më e lumtur për të gjithë. Pra, sikur të mos ekzistonte urrejtja, nuk do të kishim as një lloj diskriminimi. Që të dyja kanë bashkëjetuar, bashkëjetojnë e do të bashkëjetojnë, si dhe që të dyja i kanë shkaktuar, i shkaktajnë dhe do t'i shkaktajnë vuajtje njerëzimit. Ngarkesa e organizmit të njeriut me energji negative, e cila mund të ketë gjenezë dhe shkaktarë të ndryshëm, e përmbush njeriun me plot urrejtje. Kësisoj punëdhënësi i shtyrë nga urrejtja i diskriminon vartësit e tij në punë. Lidhur me këtë, veçoj këto lloje diskriminimesh:


1. Diskriminimi si burim i urrejtjes personale;
2. Diskriminimi si burim i qëllimeve të caktuara politike;
3. Diskriminimi nga urrejtja profesionale.

1. Diskriminimi në punë si burim i urrejtjes personale

Që një trajtim jo i pabarabartë të jetë diskriminim, ai duhet të bazohet në ndonjë karakteristikë personale. Karakteristika e personave, në të cilën diskriminimi është bazuar quhet "bazë e diskriminimit". Ndonjëherë ndodh që të vepohet jo barabartë ndaj ndonjë personi, por ajo sjellje nuk mund të karakterizohet si diskriminim sepse nuk është e bazuar në karakteristikën personale të atij personi, edhe nëse janë në pyetje sjelljet të cilat nuk janë të pranueshme, jo të drejta dhe jo profesionale: p.sh shefi i një departamenti, në të cilin të gjithë të punësuarit vonohen me ekzekutimin e detyrave të punës, e dënon vetëm një të punësuar, ndërkohë që punëtorët e tjerë vetëm i paralajmëron verbalisht; zyrtari i administratës publike e pranon pa rradhë një person të cilin e njeh, ndërsa të tjerët presin në rradhë; drejtori i ri i firmës keqtrajton dhe nënçmon punëtorin, e cila është bashkëshorte e drejtorit paraprak. Mirëpo ne për objekt trajtimi në këtë situatë kemi urrejtjen personale të punëdhënësit, e cila krijohet në të shumtën e rasteve shkallë-shkallë e shumë rrallë në çast. Urrëjtja e ngadaltë është shumë më e keqe se ajo vullshme, sepse e para ngulitet aq shumë në mendjen e njeriut sa ai (punëdhënësi) pret vetëm rastin e duhur për ta dëshmuar superioritetin ndaj vartësit. Faktorët ndikues të urrejtjes personale, janë të shumtë e të shumëllojshëm, disa po i theksojmë më poshtë:

- a) si pasojë e vogëlisë (inferioritetit) ndaj shokut që nga fëmijëria;
- b) si pasojë e konflikteve ndër-familjare;
- c) si pasojë e konflikteve personale;
- d) si pasojë paragjyqimeve dhe si refleksion i traditës negative të urrejtjeve mes lokaliteteve (fshatrave), krahinash, etj.
- e) si pasojë e veseve negative të udhëheqësit.

a) -Diskriminimi në punë si pasojë e vogëlisë, zakonisht, gjenezën e ka që nga fëmijëria, ku vartësi në të gjitha pikëpamjet ka dominuar ndaj punëdhënësit aktual. Pra, ai ka qenë më i bukur, më i fuqishëm, më i dashur për rrethin, më i zoti në mësim, në adoleshencë etj. Të gjithë këta faktorë, kanë ndikuar që punëdhënësi (padroni) gjatë tërë jetës të ketë akumuluar



shumë urrejtje. Por ja që fati e ka dashur, që tani ai më i dobëti të bëhet më i fuqishëm se bashkëmoshatari tij. Ai e trajton keq në punë (e diskriminon) shokun e tij të fëmijërisë, sepse do t'i dëshmojë atij që sa i fuqishëm është ai. b) -Diskriminimi në punë si pasojë e konflikteve familjare - fatkeqësisht është i pranishëm edhe pse në shumë raste, punëdhënësi (padroni, udhëheqësi) diskriminimin e shpreh në mënyrë të kamufluar. Ai, zakonisht pa marrë parasysh aftësitë profesionale të vartësit, nuk e trajton në mënyrë të barabartë me kolegët e tjerë të punës. Edhe nëse nuk i shpreh ndonjë kritikë personit të urreyer familjarisht, nuk i jep pagë të njëjtë. Qëllimi i padronit është, që vartësit t'ia bëjë jetën sa më të vështirë.

c) Konfliktet personale - punëdhënës, drejtues-vartës, ato mund të kenë pasur histori para se të ndodheshin në këto role. Tani me ndryshimin e roleve, më i forti e diskriminon në mënyra të ndryshme personin tjetër. Diskriminimi mund të reflektojë edhe si pasojë e garës për postin e njëjtë. Në këto raste fituesi në vend se, të tregohet zemërgjerë ai e diskriminon rivalin e tij në punë, sepse urrejtja e çon në atë drejtim. Konflikti mund të lindë edhe pas ardhjes në rolin e drejtuesit me vartësin e tij. Mund të jetë ndonjë mospajtim që shpërthen në konflikt personal, e në këto raste s'ka dyshim se e pëson më i dobëti.

d) Diskriminimi në punë si pasojë e paragjyqimeve të krijuara brenda një rrethi a grupi, i cili në rrugën zhvillimit të individit gjatë tërë kohës, për grupin tjetër të njerëzve që ka jetuar pranë tij (lagje fqinje, fshat fqinj apo edhe krahinë fqinje) gjithmonë ka dëgjuar vetëm fjalë të këqija; pa dyshim që tek ai individ urrejtja e grupit (kolektive) është mbëltuar edhe në ndërdijen e individit. Dijetarët në shumë raste, ndërdijes i kanë kushtuar shumë vëmendje, ku refleksionet e saj kushtëzohen prej llojit të ideve krejt dominuese në të. Pra, nëse ato dominohen nga ato pozitive, edhe reflektimi do të jetë krejt pozitiv; në rast se dominojnë ato

negative reflektimi negativ do të jetë i pa shmangshëm. Me këtë rast kemi ndërtimin e paragjyqimeve negative të bartura, pavetëdijshëm tek individ. Pronari apo drejtuesi i një institucioni qoftë publik a privat, i ngarkuar me paragjyqime të tilla, prirjet diskriminuese ndaj vartësit të tij i cili dhe ka jetuar pranë tij, i shpreh në mënyrat që i konsideron të përshtatshme. Atij i duket se e njeh personin, por në të vërtetë e njeh fare pak dhe krejt sipërfaqësisht. Këto prirje diskriminuese shfaqen që nga procesi i punësimit, pra, atë nuk e merr dot në punë personin e grupit tjetër, qoftë edhe mungesa e plotë e konkurrencës e kërkuar sipas kriterëve të parapa. Këto kundërshti absurde për fatin e keq janë shumë të pranishme në vendin tonë. Për shembull gjithmonë flitet për rivalitetet mes fshatrave: apo kjo anë lumit - me anën tjetër të lumit; malësi-rrafsh etj. Po ashtu është i njohur edhe paragjykimi në relacionin fshat-qytet (fshatar-qytetar).

e) Diskriminimi në punë si pasojë e veseve negative të udhëheqësit - s'ka dyshim se, diskriminimin mund ta përfshijë individit por edhe grupi. Varet krejt prej veseve të padronit dhe në cilën shkallë e shfaq vesin ai. Ndodh shpesh që në rolin drejtues të jetë personi me prirje narcisoide, tjetri me ato prepotente. Këto janë më shumë patologji të njerëzve, prandaj si ata narcisoidë (të dashuruar në vetveten), si ata prepotentë (që e mbiçmojnë vetveten), nuk diskriminojnë vetëm individin por edhe tërë grupin, sepse tek ata është e mbëltuar ndjenja e më të fuqishmit, më të mirit, më të dijsmit e më të mençurit. Sipas tyre, vlera e tyre individuale, është më e madhe jo vetëm se individit por edhe se grupi. Veprimet e individëve të tillë, nuk mund të kenë jetë të gjatë por diskriminimi, qoftë në procesin e punësimit a në punë, shpërfaqet shpejt. Si ves shumë negativ i udhëheqësit, është edhe marrja e tij me përfoljet e ndryshme që mund të bëhen për të nga nëpunësit, që udhëhiqen prej tij. Zakonisht, ai porositi dikë apo edhe një grup prej 2-3 vetash të informohet se, kush dhe çfarë po thotë për të. Si ud-

hëheqësi, ashtu edhe punëtorët mjeranë, që merren me këso farë idesh, prishin frymën e punës dhe marrëdhëniet mes kolegëve të punës.

2. Diskriminimi në punë si burim i qëllimeve të caktuara politike

Diskriminimi mund të përkufizohet si një sjellje e tillë (trajtim i pafavorshëm), gjatë së cilës, individë të caktuar apo grupe individësh vendosen në pozitë të pafavorshme (për dallim nga individë të tjerë, të cilët në situatë të ngjashme, nuk janë trajtuar në atë mënyrë), në bazë të ligjit për sjellje të ndaluar dhe në situatat në të cilat parashihet me të drejtë ligjore. Andaj si kudo në botë, lufta la pasoja të rënda, ku më së keqi e pësuan shqiptarët. U vranë e u masakruan mijëra njerëz moshash e gjinish të ndryshme, u dogjën dhe u shkatërruan mijëra shtëpi, u dëbuan nga vatrata familjare miliona njerëz. Ky shkatërrim kaq masiv, la pasoja të ndryshme tek njerëzit. Pasoja më e madhe ishte se, bindjet politike të njerëzve nuk u konsideruan si konkurrencë e ideve për zhvillimin por si formë e diskriminimit, fatkeqësisht edhe në ditët e sotme të gjitha këto burimin e kanë tek urrejtja ideologjike a te bindjet politike. Prandaj duhet ofruar mbrojtje për ata të cilëve iu shkelen/anashkalohen të drejtat, për shkak të përkatësisë politike, apo për shkak se ata kanë bindje të caktuara. Për më tepër, është sugjeruar që diskriminimi mbi këtë bazë ofron mbrojtje për aktivitetet apo demonstrimet e kundër parimeve të vendosura politike, sistemit apo sunduesve. Diskriminimi mbi këtë bazë mund të paraqitet në një sërë kontekstesh si në punësim posaçërisht në sektorin publik, lidhur me lirinë e shprehjes, si dhe në qasjen në shërbime të caktuara, sikurse marrja e tenderëve apo kontratave në procesin e prokurimit publik.

3. Diskriminimi në punë nga urrejtja profesionale

Aftësitë profesionale të dëshmuara të vartësit, punëdhënësin e bëjnë shumë xheloz ndaj vartësit. Në të vërtetë ajo xhelozia me siguri që ka një histori, kështu që pozita e tij e pushtetshme është rast i mirë për ta diskriminuar kolegun e tij më të aftë profesionalisht. Diskriminim i tillë shfaqet më shumë në institucione publike dhe private. Udhëheqësi këtë urrejtje, e shpreh kur për punë të njëjtë dhe me nivel të njëjtë të arsimimit nuk i trajton njësoj në pagë kolegët e punës. Janë të çuditshme këto sjellje ksenofobie sepse njerëzit me origjinë të njëjtë a identike, të lindur me një territor të përbashkët, nuk do të duhej për asgjë të trajtohen si të huaj.

Diskriminimi në punë si burim i qëllimeve përfituese amoralë

Njerëzit, sidomos ata të pushtetshmit, jo në pak raste kanë abuzuar me pozitën e fituar. Format e abuzimit me pozitën në pushtet janë të shumta, por tejet vështirë të zbardhshme. Megjithatë, format e abuzimit janë të mundshme për dy fushë-veprimtaritë:

1. Abuzimi/et në institucionet publike;
2. Abuzimi në sektorin privat.

1. Abuzimet në institucionet publike
Duhet theksuar fakti se, në shumë raste mund të gjejmë ngjashmëri në të dy

fushë-primtaritë e përmendura, por në ndonjë rast ato dallojnë. Së pari po i theksojmë disa sjellje abuzive, karakteristike për institucionet publike:

a) Tendero-mania - Asnjëherë më parë se sa në vitet e fundit, nuk është përdorur dhe nuk është konsumuar më shumë fjala e huaj tender, që në shqip do të thotë ofertë. Fjalën tender e dëgjon gjithkund dhe kudo që të jesh. Kjo fjalë përdoret nga ndëjat më të thjeshta, qoftë edhe në ndonjë fshat të thellë malor e deri në nivelet më të larta të insitucioneve. Fjalën tender e dëgjon në shtëpi, në zyra institucionesh, në kafene, në kinema, në teatër, thjeshtë gjithkund dhe kurdo. Çështja ka shkuar aq larg, sa po t'i pyesësh personat, të cilët janë të përfshirë në përfitime tenderësh dhe që për fat të keq nuk janë të paktë, se ç' kuptim ka në të vërtetë fjala "tender", meqë nga ky nocion ata kanë përfituar shifra marramendëse të parave, të njëjtit persona nuk e dinë ç'do të thotë kjo fjalë dhe mbeten si të nemitur. Shumë kompani dhe ndër-marrje vendore pikërisht për shkak të tenderëve edhe kanë falimentuar! Këto fenomene kanë ndodhur për të vetmin shkak se përqindjen, apo "prenë e gjahut" është dashur ta ndajnë te disa persona, pra për të gjithë ata persona që ishin të përfshirë në tenderë dhe kështu shumë pronarë të kompanive vendore kanë falimentuar, pasi ata ishin të detyruar që nga xhepi i tyre të kryejnë projektin e paraparë sipas tenderit të shpallur, pasi fitimi i tyre ishte zero-zero. Këta përfitues, kanë dëmtuar rëndë punën cilësore, sepse punëmarrësi ka obligim që në dëm të cilësisë së punës t'i mbush xhepat e tij. Diskriminimi realizohet në atë mënyrë, që nuk përzgjidhet kompania e cila e meriton e si rrjedhojë këto kompani e kanë vështirë të mbijetojnë.

b) Shantazhimi i femrës në procesin e punësimit. - Kur flasim për të drejtat të lidhura me punën, masat mbi parimet e mos diskriminimit dhe trajtimit të barabartë nuk mund të lihen anash. Rregullat e mos diskriminimit dhe trajtimit të barabartë mbizotërojnë të gjithë ligjin e të drejtave sociale. Kujdes të veçantë duhet të kemi për rregullat të cilat sigurojnë trajtim të barabartë të femrës në tregun e punës. Janë shqetësuese ngacmimet seksuale dhe mundësia jo e barabartë në fushën e punësimit për gratë dhe burrat. Shantazhimi i femrës në procesin e punësimit është njëra prej shëmtive më të papranueshme dhe njëra prej formave më të këqija për skllavërimin e femrës. Prandaj njerëzit që nuk hezitojnë që varfërinë e skajshme të femrës e shfrytëzojnë për shfryrje epshesh, është shumë vështirë t'i gjendet emri i saktë; t'i quash të poshtër, mjeranë a të ligj është shumë pak. Është e qartë se, kushti i tyre për punësim është nënshtrimi i pa vullnetshëm, pa dëshirë dhe pa dashuri ndaj një mashkulli që po të mos vareshin për ekzistencë do t'u vinte ndot deri në vjellje për të. Gjithashtu, rastet e tilla ndodhin edhe në procesin e punës, ku në mungesë të funksionimit të ligjit, ajo (femra) shantazhohet me përjashtim nga puna apo edhe ndërrim të vendit të punës, si dhe ndonjë formë tjetër abuzive.

Shefe e sektorit të Botimeve
Anjeza Musollari



Gradualisht, me rritjen e modernizimin e ushtrisë, u shtua dhe u modernizua edhe shërbimi kimik, që ndonjëherë edhe e quanim Arma e Kimisë, për vetë përmasat dhe rëndësinë, që mori. Kështu, qysh më 1961, kompania e kimisë u kompletua me teknikën e armatimit kimik, me teknikë zbulimi dhe përpunimi. Rëndësi e veçantë, fillimisht, i kushtohet përvetësimit të teknikës dhe kompletimit të ushtrisë me mjetet e mbrojtjes kundërkimike.

Arma e Kimisë 68 vite histori, përkushtim, zhvillim shkencor

Intervistoi: ANJEZA MUSOLLARI

Intervistë me Drejtorin e Laboratorit Qendror të FA, nënkolonel Dod Vukaj

Shërbimi Kimik i Ushtrisë gjatë gjithë kohës ka qenë shërbim elitë që përgjigjej para këshillit të Mbrojtjes për vetë natyrën dhe rëndësinë e veçantë të detyrave që ai zgjidhte për Mbrojtjen e Forcave të Armatosura të popullit e të ekonomisë. Periudha 68-vjeçare e këtij shërbimi ka qenë një periudhë e gjatë pune vetëmohuese e përkushtimi nga qindra kuadro e mijëra ushtarë që kanë shërbyer në këtë armë, që me punën dhe sakrificat e tyre e çuan këtë shërbim në nivelet më të larta të mundshme, shërbim sa i vështirë aq dhe i nevojshëm, si për kohë lufte dhe për kohë paqeje, shërbim human që mbron dhe shpëton jetë njerëzish në çdo situatë. Kjo ka qenë dhe do të mbetet përherë detyra e mbrojtjes kundra-kimike.

Kur është krijuar arma e kimisë?

Nënreparti i parë i shërbimit të mbrojtjes kundërkimike u krijua më 23 nëntorin e vitit 1953. Komandanti i Nënrepartit të parë të shërbimit kimik (Kështu quhej struktura e parë e krijuar) u emërua zoti Shyqyri Kondi. Po në këtë kohë me urdhër të Këshillit të Mbrojtjes u krijua edhe Dega e Mbrojtjes kundërkimike pranë Shtabit të Përgjithshëm.

Cilët kanë qenë kuadrot e parë të armës së kimisë?

Kuadrot e parë ishin ata të dalë nga lufta antifashiste dhe të përgatitur me kurse dhe kryesisht në shkollat ushta-

● *Nënreparti i parë i shërbimit të mbrojtjes kundërkimike u krijua më 23 nëntorin e vitit 1953. Komandanti i Nënrepartit të parë të shërbimit kimik (Kështu quhej struktura e parë e krijuar) u emërua zoti Shyqyri Kondi. Po në këtë kohë me urdhër të Këshillit të Mbrojtjes u krijua edhe Dega e Mbrojtjes kundërkimike pranë Shtabit të Përgjithshëm.*

rake të ish Bashkimit Sovjetik, dhe më vonë në Akademinë tonë të Mbrojtjes si Shyqyri Kondi, Kristaq Haxhimiali, Thodhori Gjoni, Hamit Murga, Uran Puto, Abdyl Dobi, Esat Xhepa Guri Shyti, Lame Prifti, Qëndro Laba, Enver Lagji, Hysen Murtati, Sami Meçollari, Hysen Kola, Kristaq Mici, Pirro Begvarfi, Zija Liçi, Servet Muka e shumë e shumë të tjerë që dolën më vonë nga Shkolla e Lartë e Bashkuar e Oficerëve, të cilët punuan me përkushtim e ndjenjë të lartë përgjegjësie.

Si ka evoluar në vite kjo degë nga pikëpamja e burimeve njerëzore dhe teknologjike?

Në vitin 1954, pranë Shkollës së Bashkuar të oficerëve u hap edhe kursi i kimisë, që filloi të përgatiste kuadrot e parë të vendit, të cilët me ndjenjë të lartë dhe përkushtim rritën nivelin

teknik dhe gatishmërinë luftarake të reparteve dhe njërive të Ushtrisë.

Gradualisht, me rritjen e modernizimin e ushtrisë, u shtua dhe u modernizua edhe shërbimi kimik, që ndonjëherë edhe e quanim Arma e Kimisë, për vetë përmasat dhe rëndësinë, që mori. Kështu, qysh më 1961, kompania e kimisë u kompletua me teknikën e armatimit kimik, me teknikë zbulimi dhe përpunimi. Rëndësi e veçantë, fillimisht, i kushtohet përvetësimit të teknikës dhe kompletimit të ushtrisë me mjetet e mbrojtjes kundërkimike.

Në vitin 1964 pranë Akademisë së Shtabit të Përgjithshëm u hap dega e Mbrojtjes kundërkimike, me shef katadre N/kolonel Kristaq Haxhimihalin, prej ku filluan të dalin kuadrot e lartë ushtarake.

Në vitin 1967 me vendim të Këshil-

lit të Mbrojtjes u krijuan tre batalione, dy të mbrojtjes kundërkimike, njëri në Tiranë me komandant Koço Stojkun dhe tjetri në Berat me komandant Refat Shehatin, kurse batalioni i tretë ishte ai flakëdhës në Tiranë me komandant Ahmet Mehmetin, që të tre Rezervë të Shtabit të Përgjithshëm. Po në këtë kohë pranë shtabeve të divizioneve u krijuan kompanitë e mbrojtjes kundërkimike dhe ato flakëdhëse, të cilat me kalimin e Ushtrisë në sistemin me Korpuse ato kaluan në batalione kimie dhe flakëdhëse, të kompletuara me teknikë dhe armatim të plotë kimik. Po kështu, pranë korpuseve u krijuan edhe laboratorët e kimisë të korpuseve me shefa laboratorësh, inxhinierë, kimistë, që kishin në vartësi edhe oficinat e riparimit të teknikës dhe armatimit kimik të korpusit dhe, që kanë bërë një punë të lavdërueshme për rritjen cilësore teknike të këtij shërbimi.

Më 1969 pranë reparteve të kimisë, këtu në Brar, u krijua Shkolla e përgatitjes së kuadrove oficer rezervist, me komandant Muharrem Durmishi.

Zhvillimi i vullshëm i shërbimit kimik bëri që edhe drejtimi të kalonte nga degë në Drejtori të Mbrojtjes kundërkimike. Në këtë kohë, kur drejtorë ishin zotërinjtë Enver Lagji dhe Muharrem Durmishi, u bë një punë shumë e madhe në drejtim të studimit dhe prodhimit në vend të mjeteve të mbrojtjes kundërkimike dhe të

likuidimit të pasojave të ndotjeve. Është, pikërisht, kjo kohë kur u krijuan shumë grupe pune studimore me specialistët më të mirë, të cilët u kurorëzuan me sukses deri në krijimin e uzinës së kimisë, që prodhoi kundërgazin shqiptar me parametra të matshëm me bashkëkohorët, u prodhuan paketa individuale kundërkimike, kompletet e degazimit e përpunimit, kostumet mbrojtëse e kompleti mbrojtës Nr.1 e shumë të tjera.

A ishte ky një laborator i mirëfillt shkencor?

Pranë ambienteve të kompanisë së kimisë, më 1 gusht 1965, u hap Laboratori Qendror kimik i Ushtrisë, me kimistin e talentuar Kudret Meta dhe dy laborantë. Hapja e këtij Laboratori kishte si qëllim përgatitjen teknike të kuadrove të mesëm dhe të lartë të kimisë por, kryesisht si një bërthamë studimore për aplikimin në ushtri të të rejave shkencore lidhur me ADM (Armët e Dëmtimit në Masë) dhe mbrojtjen prej tyre, sidomos në drejtim të armës së kimisë dhe mjeteve djegëse, për t'iu përgjigjur situatave të mundshme kimike, që mund të krijoheshin, duke e përqendruar vëmendjen fillestare në këto probleme:

- gjetja dhe aplikimi i metodave të analizave të lëndëve helmuese luftarake;
- kryerja e analizave të lëndëve ç'ndotëse, që mbahen në ruajtje;
- aplikimi i metodikave për përgatitjen dhe përdorimin e mjeteve ç'



ndotëse;

- studimi i aftësisë mbrojtëse të mjeteve të mbrojtjes kundërkimike;
- përgatitja e përzierjeve djegëse për flakëdhëset.

Jo vetëm kaq, por prodhoi dhe furnizonte edhe industrinë me gypa indikator për gazrat e dëmshëm industrial, hoqi nga importi shumë kimikate dhe lëndë të tjera të domosdoshme për prodhimin e këtyre gypave, merrte pjesë dhe thoshte fjalën e fundit në analizat kimike në raste të ndryshme ndotjesh në ekonomi.

Por, a ka pasur Shqipëria armë kimike dhe, a ka qenë ajo e aftë ta përdorë armën kimike kundër të tjerëve?

Jo. Çuditërisht Ushtria shqiptare e para viteve '90, e ngarkuar për së tepërmi me tanke, avionë, raketa dhe artileri kundërajrore, çuditërisht nuk ka pasur në përdorimin e saj “armë kimike”, por thjesht vetëm Lëndë Helmuese Luftarake (dhe këto në sasinë më të madhe të tyre ishin mësimore, me një përqindje tepër të ulët të lëndës aktive). Lëndë Helmuese Luftarake, të cilat bashkë me mjetet e tyre të përdorimit të cilat nuk disponoheshin nga vendi ynë krijojnë armën e kimisë. Mjetet me të cilat mund të përdoren këto lëndë helmuese janë që nga më e vogla: granatat e dorës, artileria, aviacioni dhe raketat. Të kemi parasysh gjithmonë, në rast se predhat janë të mbushura me lëndë helmuese luftarake kthehen në armë kimike.

Po pse atëherë ne posedonim këto LHL?

Ato përdoreshin për stërvitje, për eksperimentime dhe studime të ndryshme.

Shqipëria asnjëherë nuk ka disponuar armë kimike. Shqipëria ka disponuar vetëm një nga dy komponentët e Armës së kimisë, Lëndë Helmuese Luftarake (LHL) që sot

sipas koncepteve të reja i emërtojmë agjentë kimik.

Ushtria shqiptare ka pasur lëndë helmuese si: “Sarinë”, “Iprit”, “Acid Cianidrik”, etj. Këto lëndë më tepër kanë shërbyer për eksperimentime, por jo për t’u përdorur si armë kimike. Ndërkohë është përdorur për stërvitje të kufizuar me trupa, “Iprit” i holluar në masën 5 për qind.

Aktualisht, a ka LHL sot në Shqipëri?

Që nga viti 2007, me mbështetjen e qeverisë Amerikane dhe nën monitorimin e plotë të OPCW (Organizata për ndalimin e armëve kimike), u bë asgjësimi i plotë i të gjithë sasisë së LHL(Agjent kimik) që ka disponuar Shqipëria.

Çfarë është arma kimike?

LHL (Agjentët kimikë) + Mjetet e përdorimit = Arma kimisë. Pra siç thamë më lart ushtria

jonë ka pasur në dispozicion vetëm një nga dy komponentët që përbëjnë armën e kimisë LHL dhe nuk ka disponuar asnjëherë mjete të përdorimit të tyre.

Cilat quhen lëndë helmuese luftarake?

Ka disa përkufizime mbi LHL (agjentët kimikë):

Sipas Teksteve shkollore, Lëndë helmuese luftarake (LHL) quhen ato përbërje kimike, djegëse, tymformuese etj., të cilat plotësojnë disa kushte dhe kanë disa cilësi, që bëjnë të mundur përdorimin e tyre luftarak për dëmtimin e njerëzve, kafshëve dhe bimëve; për ndotjen e terrenit ku kryhen veprimet luftarake, të teknikës luftarake, pellgjeve ujore, godinave etj.

Sipas OKB-së, agjentët kimikë janë substanca kimike, në gjendje të gaztë, të lëngët ose të ngurtë, të cilat

mendohen të jenë përdorur për shkak të efekteve të tyre helmuese, mbi njerëzit, kafshët dhe bimët.

Sipas konventës së ndalimit e përdorimit të AK, në agjent kimik futet çdo kimikat, i cili përmes veprimit të tij kimik, mbi proceset jetësore, mund të shkaktojë vdekjen, humbjen e përkohshme të veprimit (të aftësive) ose dëmtimit të përhershëm tek njerëzit dhe kafshët.

Sipas NATO-s, është një substancë e cila është paracaktuar për përdorimin në operacione luftarake, për të vrarë, dëmtuar seriozisht ose për të bërë të pa aftë njerëzit, përmes efekteve fiziologjike të saj.

Ju jeni specialist e njohës i kësaj fushe, sa lëndë helmuese luftarake ka pasur Shqipëria në vitet e monizmit?

Shqipëria deri në vitin 2007, ka trashëguar nga sistemi i kaluar ko-

munist rreth 16 ton iprit mësimor, sasi të vogla të klorpikrinës – LHL ngacmuese – asfiktike, që është përdorur vetëm në luftën e parë botërore për qëllime luftarake. Po ashtu, kemi pasur sasi të vogla (jo me ton dhe kuintal, por me kg- iprit luftarak, luizit dhe sarinë, që janë përdorur për studime shkencore. Vonë janë sjellë sasi të vogla kloracetofeni.

Mund të na thoni diçka për efektet e gazit sarinë?

Sarina është një agjent kimik i cili i përket grupit fosfor-organike, të cilat veprojnë për dëmtimin e funksioneve të muskujve, veprojnë në transmetimin prej nervave të impulseve në sistemin nervor. Sarina në temperatura të larta është një agjent i paqëndrueshëm, është shumë toksike. Infektimi me sarinë shfaq simptomat si rrjedhje e hundëve, shtrëngim në kraharor, zvogëlim i të parit, vështirësim i frymëmarrjes, të përziera, vjellje dhe pas disa minutash vdekja.

Me të avulluar, sarina kthehet në gaz që mund të shpërndahet në mjedis. Njerëzit ekspozohen ndaj sarinës nëpërmjet kontaktit me lëkurën, me sytë, ose duke e thithur atë nëpërmjet ajrit. Sarina gjithashtu mund të përzihet me ujin e pijshëm ose ushqimin. Sarina është një agjent ekstremisht i paqëndrueshëm për shkak të aftësisë për të ndryshuar nga lëngu në gaz.

Ka të dhëna që është përdorur nga regjimi i Saddam Hysenit kundër Iranit në luftën dhjetëvjeçare që nisi në 1980 dhe më pas në 1986 ku janë vrarë rreth 5000 veta.

Në vitin 2013, Bashar al-Assad u bë lideri i radhës që i përdori këto armë gjatë kulmit të luftës civile në Siri. Sulmet targetonin grupet opozitare që kontrollonin vendet pranë kryeqytetit. Inspektorët e OKB-së kanë konfirmuar përdorimin e gazit sarinë në atë sulm që kishte vrarë gati 1500 vetë. Por Assadi, ende e mohon të ketë qenë i përfshirë në ato sulme.

Rasti tjetër mjaft i njohur i përdorimit të sarinës me qëllim aktesh terroriste është i përdorur nga grupi terrorist “Kulti i ditës së gjykimit Aum Shinrikyo”, me lider Shoko Asahara, i cili shpërndau sarinë në sistemin e metrove të Tokios më 1995, ku pati 13 të vdekur dhe afro 3500 të lënduar.

Nga eksperiencia juaj e gjatë, a keni eksperimentuar (helmuar) me sarinë? Nëse po, keni dokumente për këtë qëllim?

Laboratori Kimik në vitin 1969 arriti, që me këmbëngulje të sintetizonte (prodhonte) pothuajse të gjitha llojet e LHL që njiheshin, përfshi sarinën në sasi shumë të vogla dhe kjo është bërë për të pasur mundësi të studioheshin e prodhoheshin mjetet e zbulimit të tyre kimik, të mbrojtjes prej tyre dhe të ç’ ndotjes së tyre. Laboratori prodhoi të gjithë gypat indikator të lëndëve helmuese. Sasitë e saj kanë qenë tepër të vogla dhe nuk është përdorur asnjëherë për qëllime luftarake, manovra apo stërvitje.



Veprimet e Rosisë demonstrojnë një model sjelljeje të papërgjegjshme

Deklarata e NATO-s për testin e fundit të raketës anti-satelitore të kryer nga Federata Ruse

Deklarata e Këshillit të Atlantikut të Veriut për testin e fundit të raketës anti-satelitore të kryer nga Federata Ruse:

1. Këshilli i Atlantikut të Veriut dënon fuqimisht testin e pamatur dhe të papërgjegjshëm të raketave anti-satelitore të Federatës Ruse, më 15 nëntor 2021. Ky test shkaktoi një fushë mbeturinash orbitale që rrit ndjeshëm rrezikun për jetën e njerëzve dhe për asetet e bazuara në hapësirë të shumë kombeve dhe subjekteve.

2. Veprimet e Rosisë demonstrojnë një model sjelljeje të papërgjegjshme dhe rrezikojnë interesat e sigurisë,

ekonomike, shkencore dhe tregtare të të gjitha kombeve dhe aktorëve që kërkojnë të eksplorojnë dhe përdorin hapësirën e jashtme për qëllime paqësore.3. Kjo sjellje e rrezikshme bie ndesh drejtpërdrejt me pretendimet e Rosisë për të kundër-



shtuar “armatizimin” e hapësirës dhe minon rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla. 4. Aleatët e NATO-s mbeten të përkushtuar për të mbrojtur dhe ruajtur aksesin paqësor dhe eksplorimin e hapësirës për të gjithë njerëzimin. Ne u bëjmë thirrje të gjitha kombeve, përfshirë Rusinë, t’i bashkohen përpjekjeve ndërkombëtare për të zhvilluar norma, rregulla dhe parime të sjelljes së përgjegjshme në mënyrë që të reduktohen kërcënimet në hapësirë dhe të përmbahen nga kryerja e testeve shkatërruese të rrezikshme dhe të papërgjegjshme si ato të kryera nga Federata Ruse.

Forumi NATO-Industri

Fjala e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s Jens Stoltenberg në Forumin e Industrisë së NATO-s (NIF) në Romë, Itali

“Ky është një forum që mezi pres të marr pjesë çdo vit, sepse është një platformë e rëndësishme për t’u angazhuar me industrinë. Angazhimi ynë me industrinë është i gjatë.

Është shumë e rëndësishme dhe është reciprokisht e dobishme. Nga njëra anë, NATO dhe Aleatët varen nga industria për të na ofruar aftësitë që na duhen, nga ana tjetër, industria varet nga vendimet e marra nga NATO për të formësuar tregun ku vepron.

NATO përcakton udhëzimet se sa aleatët investojnë në mbrojtje dhe për çfarë do të shpenzojnë paratë, duke rënë dakord për objektivat e aftësisë për çdo aleat. Ne vendosëm gjithashtu standardet që sigurojnë ndërveprim. Lajmi i mirë është se që nga viti 2014, që kur bëmë zotimin në Uells për të filluar rritjen e shpenzimeve të mbrojtjes, të gjithë aleatët kanë rritur shpenzimet e mbrojtjes. Kemi shtatë vite, shtatë vite radhazi rritje të shpenzimeve të mbrojtjes në të gjithë Aleancën dhe në vitin 2014 vetëm tre aleatë plotësuan udhëzimet për shpenzimin e 2% të PBB-së për mbrojtje. Tani në fakt dhjetë aleatë shpenzojnë 2% të PBB-së për mbrojtjen. Dhe shumica e aleatëve kanë një plan për të arritur këtë objektiv.

Pra, në total gjatë shtatë viteve të fundit, kjo ka shtuar 260 miliardë dollarë shtesë për mbrojtjen dhe kjo me të vërtetë formon tregun dhe ju, si industri në të cilën po vepron. Pastaj ju industria, sektori privat, industria e mbrojtjes, ju ushqeni inovacionin. Me paratë shtesë, ju ruani dhe përmirësoni aftësitë tona ekzistuese dhe ju zhvillonin dhe prodhoni të reja. Kjo është thelbësore për të siguruar që ne të mbajmë avantazhin tonë teknologjik, dhe për të mbrojtur qytetarët tanë. Pra, është në interesin tonë të përbashkët të punojmë shumë ngushtë së bashku. Siç bëjmë ne në fakt.

Vitet e fundit, ne kemi zhvilluar aftësi moderne që integrojnë disa nga teknologjitë më të fundit, si sistemi i Mbikëqyrjes Tokësore të Aleancës, që ofron imazhe të radarëve me cilësi të lartë dhe operon nga Italia. Unë në fakt vizitova bazën. Është shumë mbresëlënëse si aftësia si e tillë, por edhe njerëzit dhe aftësitë në terren për përpunimin e të dhënave që mbliidhen nga Sistemi i Mbikëqyrjes Tokësore të Aleancës. Aktualisht jemi duke punuar në sistemin e mbikëqyrjes dhe kontrollit të së ardhmes së Aleancës për të zëvendësuar AWACS-të tanë dhe për të qenë të rinj, “sytë tanë në qiell”. Ne po testojmë gjithashtu sistemet detare pa pilot dhe zhvillimin e gjeneratës së ardhshme të helikopterëve.

Duke punuar së bashku, ne ndihmojmë

të sigurohemi që aleatët të jenë në gjendje të operojnë teknologji të ndryshme pa probleme, mes forcave të tyre, dhe me njëri-tjetrin. Avancimi i ndërveprimit është çelësi i efektivitetit tonë.

Duke parë përpara, partneriteti ynë me industrinë e mbrojtjes dhe teknologjisë – në të gjithë Evropën dhe Amerikën e Veriut – do të jetë edhe më kritik, sepse aftësia jonë për të inovuar po sfidohet seriozisht. Më shumë vende anëmbanë botës po garojnë për të zhvilluar teknologji të reja nga inteligjenca artificiale deri te avionët hipersonikë. Dhe ne në fakt kemi parë disa testimet, si nga Rusia ashtu edhe nga Kina, të cilat treguan se po investojnë shumë në këto teknologji. Vende të tjera shpesh konkurrojnë për të dominuar këto teknologji të reja. Aleatët e NATO-s janë ende të parët në këtë garë. Por lojtarët e tjerë po arrijnë shpejt. Ata jo gjithmonë ndajnë vlerat tona ose luajnë sipas të njëjtave rregulla dhe ata po sfidojnë dominimin teknologjik të NATO-s.

Një nga lojtarët kryesorë është Kina. Së

shpejti do të ketë ekonominë më të madhe në botë. Dhe tashmë ka buxhetin e dytë më të madh të mbrojtjes. Pra, ne duhet të trajtojmë ngritjen e Kinës, e cila me të vërtetë është diçka që po ndryshon mjedisin e sigurisë me të cilin përballemi të gjithë. Kina ka buxhetin e dytë më të madh të mbrojtjes. Kina ka ambicie të bëhet lider botëror në inteligjencën artificiale deri në vitin 2030 dhe të ketë forcat e armatosura më të avancuara teknologjiksht në botë deri në vitin 2050.

Duke pasur parasysh progresin rekord që kinezët kanë bërë vitet e fundit, kjo ambicie nuk është retorike – është shumë reale. Në të vërtetë, ne shohim Pekinin duke investuar shumë në aftësi të reja moderne, dhe duke integruar me shpejtësi teknologjitë e avancuara në ushtrinë e saj.

Rusia është gjithashtu në garë. Duke bërë përparim të konsiderueshëm veçanërisht në teknologjinë hipersonike. Investimi në aftësi të reja kibernetike dhe në hapësirë.

Përballë konkurrencës në rritje nga regjimet autoritare, ne po dyfishojmë përpjekjet tona për të qëndruar në ballë të teknologjisë. Siguria dhe liria e një miliard njerëzve tanë varen nga kjo. Kjo është arsyeja pse në Samitin e NATO-s në Bruksel në qershor të këtij viti, ne morëm vendime të guximshme, përfshirë inovacionin dhe teknologjitë në zhvillim dhe shkatërruese. Si rezultat, ne po krijojmë tani një Përsheptues të Inovacionit të Mbrojtjes për Atlantikun e Veriut: DIANA, për të lehtësuar bashkëpunimin transatlantik dhe shkëmbimet mbi teknologjitë kritike midis aleatëve. Si pjesë e DIANA-s, aleatët janë zotuar të ofrojnë një rrjet qendrash testimi teknologjie dhe vendesh përshpejtuesish në të gjithë Aleancën, për të shfrytëzuar më mirë inovacionin civil për sigurinë tonë dhe për të forcuar lidhjen teknologjike midis Evropës dhe Amerikës së Veriut. Disa nga këto objekte do të jenë në funksion vitin e ardhshëm.

DIANA është pjesë e një tabloje më të madhe. Së bashku, ne po krijojmë gjithashtu një Fond të Inovacionit të NATO-s. Vetëm pak javë më parë, 17 aleatë u regjistruan për

70-vjetori i themelimit të Kolegjit të Mbrojtjes së NATO-s në Romë

Stoltenberg: Kolegji i Mbrojtjes mishëron sekretet e suksesit të NATO-s, unitetin dhe aftësinë tonë për t'u përshtatur

Duke folur në Kolegjin e Mbrojtjes së NATO-s në Romë, Sekretari i Përgjithshëm Stoltenberg tha se Kolegji është “institucioni kryesor akademik i NATO-s; dhe jep një kontribut të qëndrueshëm për sigurinë tonë të përbashkët, duke ndihmuar Aleancën tonë të përshtatet me një botë në ndryshim.” Ai theksoi se “në vitin 1951, Kolegji hapi dyert për 47 burra nga dhjetë vende të NATO-s për Kursin e parë të Lartë; që atëherë, rreth 15,000 të diplomuar kanë kaluar nëpër klasat dhe korridoret e Kolegjit; gra dhe burra; civilë dhe ushtarakë, nga 80 vende, jo vetëm nga vendet e NATO-s, por nga vendet partnere në të gjithë botën.” Ai tha më tej se “Kolegji i Mbrojtjes mishëron sekretet e suksesit të NATO-s: unitetin dhe aftësinë tonë për t’u përshtatur”.

Duke shoqëruar Komitetin Ushtarak të NATO-s, Kryetari i saj, Admirali Rob Bauer theksoi rolin vendimtar që luan Kolegji i Mbrojtjes i NATO-s brenda Aleancës dhe përshtatjen e tij. “Gjatë gjithë historisë së saj, Aleanca është përshtatur. Kjo përshtatje është ndihmuar nga Kolegji i Mbrojtjes dhe puna jetike që kanë ndërmarrë akademikët, studiuesit dhe studentët e tij. Duke bashkuar udhëheqës ushtarakë dhe civilë nga të gjithë vendet aleate dhe partnere, Kolegji ka krijuar një përvojë unike, duke i lejuar studentët dhe udhëheqësit e ardhshëm ushtarakë të vënë në dyshim konceptet e vendosura aleate, të shqyrtojnë strategjinë dhe doktrinën dhe të sfidojnë liderët – duke shqyrtuar mendimet dhe vendimet tona, dhe përfundimisht duke na bërë më të mirë për të”, -shtoi ai.

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Mircea Geoană foli gjithashtu në Kolegjin e Mbrojtjes së NATO-s mbi përpjekjet e NATO-s në lidhje me hapësirën. “Sistemet hapësinore janë thelbësore për jetën tonë të përditshme, duke mundësuar gjithçka nga telefonatat celulare, bankat, GPS, TV satelitor dhe parashikimet e motit.

Angazhimi i Aleancës me industrinë, i rëndësishëm dhe me dobi reciproke

Jens Stoltenberg: Fondi i Inovacionit të NATO-s do të investojë një miliard euro në të gjithë Aleancën



të marrë drejtimin në zhvillimin e këtij fondi të ri dhe unë pres që të bashkohen më shumë aleatë. Fondi do të investojë një miliard euro, me novatorët në të gjithë Aleancën, duke punuar në teknologjitë në zhvillim, shkatërruese dhe të gjelbra. Si DIANA ashtu edhe Fondi i Inovacionit do të shfrytëzojnë grupin e talenteve që kemi në 30 kombet tona. Ne kemi një bollëk institucionesh të shkëlqyera akademike. Studiuesit më të mirë dhe kompanitë krijuese, shumë prej të cilave janë në audiencë sot. Me mendjet më të mira, në shoqëritë e lira, ne kemi një avantazh të rëndësishëm në zhvillimin e teknologjive të reja.

Ne duhet ta përdorim këtë plotësisht. Sidomos për të zhvilluar aftësitë e ardhshme të mbrojtjes duke përdorur teknologji të pastër dhe të gjelbër. Aftësitë tona të reja ushtarake nuk mund të mbështeten në të njëjtat burime karburanti dhe energjie që kemi përdorur për shekullin e kaluar. Në COP26 në Glasgow, ne trajtuam kërcënimin e jashtëzakonshëm që paraqet ndryshimi i klimës për sigurinë e të gjithëve. NATO, ushtria dhe industria, të gjithë kanë një rol për të luajtur në adresimin e këtij kërcënimi.

Së bashku, ne duhet të ofrojmë aftësi të reja, inovative dhe të qëndrueshme që kontribuojnë drejt qëllimit të emetimeve neto zero. Në të njëjtën kohë, ne duhet të sigurojmë që të mbetemi aleanca ushtarake më e avancuar teknologjiksht. Ne nuk mund të zgjedhim mes të pasurit një ushtri miqësore me klimën apo një ushtri të fortë. Ne kemi nevojë për të dyja. NATO, industria e qytetarëve tanë dhe mbrojtja e mjedisit tonë duhet të shkojnë dorë për dorë.

Përveç DIANA-s dhe Fondit të ri, ne po vendosim strategji për teknologjitë që janë më të rëndësishme për sigurinë dhe mbrojtjen. Vetëm një muaj më parë, ne ramë dakord për strategjinë tonë të parë për inteligjencën artificiale. Ajo përcakton standardet për përdorimin e përgjegjshëm të inteligjencës artificiale, në përputhje me ligjin ndërkombëtar. Ajo tregon se si do ta mbrojmë këtë teknologji dhe adreson kërcënimet që vijnë

nga përdorimi i inteligjencës artificiale nga kundërshtarët. Në muajt dhe vitet e ardhshme, ne do të zhvillojmë strategji të tjera të ngjashme për teknologjitë kryesore, përfshirë sistemet autonome, kuantike dhe bioteknike.

Së fundi, dua të them disa fjalë për Konceptin e ardhshëm Strategjik të NATO-s, e cila është një temë qendrore në diskutimet tuaja në këtë Forum.

Koncepti i fundit Strategjik u miratua në vitin 2010 dhe ky koncept aktual strategjik na ka shërbyer mirë. Në të njëjtën kohë duhet të pranojmë se koha ka ndryshuar. Sepse kur shikoj Konceptin aktual Strategjik, ai parashikonte një partneritet të vërtetë strategjik me Rusinë dhe Kina nuk përmendet, me një fjalë të vetme. Pra, thjesht thekson rëndësinë e ndryshimit dhe përditësimit të konceptit tonë strategjik. Dhe kjo është pikërisht ajo që ne po bëjmë tani ndërsa përgatitemi për Samitin e ardhshëm të Madridit. Jam i sigurt se Koncepti i ardhshëm Strategjik për të cilin do të biem dakord në Samitin e NATO-s në Madrid në qershor të vitit të ardhshëm, do të jetë një dokument që shikon përpara. Kjo do të nënvizojë rëndësinë e unitetit transatlantik, Amerika e Veriut dhe Evropa që punojnë së bashku. Por edhe rëndësia e teknologjisë, e punës me industrinë, dhe për t’u siguruar që ne të investojmë në mbrojtje, në parandalim dhe mbrojtje, dhe se ne vazhdojmë të punojmë me industrinë për t’u siguruar që të ruajmë avantazhin tonë teknologjik.

NATO është aleanca më e suksesshme në histori për dy arsye. Së pari, sepse ne kemi qenë në gjendje të qëndrojmë së bashku pavarësisht dallimeve. Amerika e Veriut dhe Evropa kanë qenë në gjendje të qëndrojnë së bashku përballë kërcënimeve dhe sfidave të ndryshme. Arsyeja tjetër – pse NATO është aleanca më e suksesshme në histori – është se ne kemi qenë në gjendje të ndryshojmë kur bota po ndryshon. Tani bota po ndryshon. Jo më pak në fushën e teknologjisë së industrisë dhe prandaj NATO duhet të miratojë edhe një herë, jo më pak kur bëhet fjalë për teknologjinë, punën me industrinë.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s nënvizon kontributin e Malit të Zi në Aleancë

Kryeministri i Malit të Zi, Zdravko Krivokapiq vizitoi NATO-n dhe u takua me Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, në selinë e NATO-s në Bruksel.

Gjatë një konference të përbashkët shtypi, me kryeministrin Zdravko Krivokapić, Sekretari i Përgjithshëm falënderoi Malin e Zi për kontributin e rëndësishëm që po jep për sigurinë e përbashkët të Aleancës. “Trupat tuaja shërbejnë në grupin e betejës shumëkombëshe të NATO-s në Letoni; ju gjithashtu kontribuoni në misionin tonë paqeruajtës të KFOR-it në Kosovë; dhe i

mirëpres përpjekjet tuaja në promovimin e stabilitetit në rajon. E gjithë kjo tregon përkushtimin tuaj të fortë ndaj NATO-s”, -tha z. Jens Stoltenberg.

Për Ballkanin Perëndimor, Sekretari i Përgjithshëm theksoi mbështetjen e fortë të Aleancës për sovranitetin dhe integritetin territorial të Bosnje-Hercegovinës. “NATO mbetet e përkushtuar ndaj dialogut tonë të fortë politik dhe bashkëpunimit praktik me Bosnje-Hercegovinën dhe ne do të vazhdojmë të mbështesim përpjekjet reformuese të vendit”, -nënvizoi Sekretari i Përgjithshëm.



Rikonfirmim i unitetit të Aleancës përballë sfidave të sigurisë

MSC. MIMOZA GOLIKJA

Me të mbërritur në konferencën e Shoqatës Gjermane të Atlantikut “NATO Talk 2021”, në Berlin, më 19 nëntor 2021, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg përgëzoi Gjermaninë për kontributin e saj në NATO. “Gjermania është një aleat kyç, -tha Sekretari i Përgjithshëm, -dhe ajo që bën Gjermania përbën ndryshim”. Sekretari i Përgjithshëm shprehu solidaritetin e NATO-s me aleatët Poloninë, Letoninë dhe Lituaninë, të përballur me krizën në kufirin e tyre me Bjellorusinë. Ai gjithashtu ripohoi unitetin e aleatëve në trajtimin e grumbullimeve ushtarake të Rusisë në kufijtë me Ukrainën. “Ne jemi të vendosur, jemi të bashkuar në të njëjtën kohë jemi gati të bisedojmë me Rusinë për të ulur tensionet dhe për t’u siguruar që të parandalojmë çdo përshkallëzim të situatës”, -tha ai.

Duke folur në konferencë, Sekretari i Përgjithshëm, Stoltenberg theksoi rëndësinë e unitetit transatlantik përballë sfidave të sotme. “Këto sfida janë të gjitha shumë të ndryshme, por ato kanë një gjë e përbashkët”, -tha ai. “Mënyra më e mirë për t’i trajtuar ato është të qëndrojmë të bashkuar. Europa dhe Amerika e Veriut së bashku, në NATO”. Agjenda e NATO-s 2030, e cila u miratua në Samitin e NATO-s në Bruksel në qershor, synon “të forcojë edhe më shumë Aleancën tonë, si forumi i domosdoshëm për t’u konsultuar, vendosur dhe, kur është e nevojshme, për të vepruar për të gjitha çështjet që prekin sigurinë tonë”, -tha Sekretari i Përgjithshëm. “Gjermania ka një përgjegjësi të veçantë për ta mbajtur NATO-n të fortë”, -theksoi ai dhe falënderoi Gjermaninë për angazhimin ndaj Aleancës dhe kontributin e saj thelbësor gjithashtu në misionet, operacionet dhe dislokimet e NATO-s.

Është urgjente që Rusia të tregojë transparencë

Pas Konferencës Sekretari i Përgjithshëm, u takua me kancelaren gjermane Angela Merkel, për bisedimet mbi sfidat aktuale të NATO-s dhe forcimin e Aleancës, e sigurisht diskutime mbi Bjellorusinë dhe Rusinë. Sekretari i Përgjithshëm Stoltenberg tha se NATO po monitoron gjithashtu nga afër përqendrimin e madh dhe të fortë të forcave ruse pranë kufijve të tyre dhe është urgjente që Rusia të tregojë transparencë në lidhje me këtë vendosje ushtarake, të de-përshkallëzojë dhe të reduktojë tensionet. “Gjermania është një aleat kyç i NATO-s. Ju luani një rol vendimtar në marrëdhëniet transatlantike, nga mbrojtja e hapësirës ajrore të Balltikut, me misionin tuaj të policisë ajrore, te vendosjet detare në Egje. Nga forca parandaluese e NATO-s



në Lituanin, e udhëhequr nga Gjermania, te misioni ynë paqeruajtës në Kosovë, ku Gjermania jep kontribute të konsiderueshme në forcë. NATO ka nevojë për një Gjermani të fortë, si politikisht ashtu edhe ushtarakisht. Sot kemi shumë për të diskutuar. Ju përmendët disa nga çështjet kryesore. Situata në kufirin e Bjellorusisë me Poloninë, por edhe Lituaninë dhe Letoninë është thellësisht shqetësuese. Përdorimi i njerëzve të cenueshëm nga regjimi i Lukashenkos si mjet për të ushtruar presion mbi vendet e tjera është cinik dhe çnjerëzor. NATO qëndron në solidaritet të plotë me të gjithë aleatët e prekur. Ne mbetemi vigjilentë dhe jemi të gatshëm për të ndihmuar më tej aleatët tanë. Ne shohim gjithashtu përqendrim të madh dhe të pazakontë të forcave ruse pranë kufijve të Ukrainës. Është urgjente që Rusia të tregojë transparencë në lidhje me grumbullimin e ushtrisë së saj, de-përshkallëzimin dhe uljen e tensioneve”, -tha Jens Stoltenberg. “NATO po monitoron nga afër situatën dhe ne vazhdojmë të ofrojmë mbështetje politike dhe praktike për Ukrainën. Veprimet e Rusisë janë vetëm një nga sfidat me të

cilat po përballemi. Mënyra më e mirë për t’i trajtuar ato është duke qëndruar të bashkuar. Amerika e Veriut dhe Evropa së bashku në NATO, në solidaritet strategjik”, -theksoi ai.

Kancelarja Merkel, një shtyllë e fuqishme e familjes transatlantike

Sekretari i Përgjithshëm i bëri një nderim personal Kancelares Merkel, duke e falënderuar për udhëheqjen e saj të fortë dhe përkushtimin personal ndaj Aleancës transatlantike gjatë shumë viteve. “Çdo herë, më ka bërë shumë përshtypje aftësia juaj për të shkuar drejt e në pikë, për të gjetur zgjidhje dhe për të çuar përpara agjendën,” -tha ai në konferencën e përbashkët të shtypit me kancelaren e Republikës Federale të Gjermanisë, Angela Merkel. “Faleminderit për gjithçka që keni bërë për NATO-n. Vielen Dank, liebe Angela!”

“Ju keni qenë një shtyllë e familjes sonë transatlantike për kaq shumë vite”, vlerësoi Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s dhe theksoi se “Ka qenë një privilegj i vërtetë të punoj me ju. Ne u takuam, ndoshta nuk ju kujtohet, por u takuam për herë të parë në vitet 1990,

kur ju ishit ministër për mjedisin dhe unë isha ministër i Energjisë dhe më pas në 2005 fillova mandatin tim të dytë si kryeministër i Norvegjisë dhe ju u bëtë kancelare e Gjermanisë dhe që atëherë, ne kemi punuar ngushtë së bashku për të adresuar një gamë të gjerë çështjesh: kriza financiare, ndryshimet klimatike, Zbatimi i Objektivave të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara, dhe sigurisht gjatë shtatë viteve të fundit, mbrojtjes dhe sigurisë së NATO-s”, -kujtoi Jens Stoltenberg. “Dhe çdo herë, më ka bërë shumë përshtypje aftësia juaj për të shkuar drejt e në pikë, për të gjetur zgjidhje dhe për të çuar përpara agjendën. Ju e keni bërë botën një vend më të mirë. Faleminderit!”, -tha shefi i NATO-s. “Ne kemi marrë pjesë së bashku në 11 Samite të NATO-s dhe e dija se në situata të vështira, gjithmonë mund të mbështetesh te ju, mençuria juaj, përvoja juaj dhe aftësia juaj për të na ndihmuar të ndërtojmë konsensus”, -tha Stoltenberg. “Faleminderit për gjithçka që keni bërë për NATO-n dhe për mbajtjen e fortë të lidhjes midis Evropës dhe Amerikës së Veriut. Vielen Dank, liebe Angela!”

NATO po monitoron nga afër situatën në kufirin e saj Lindor

Edhe në deklaratën përpara fillimit të Konferencës së Bisedimeve të NATO-s 2021 Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s u tha medieve se Gjermania është një aleat shumë i vlerësuar i NATO-s, dhe se Gjermania kontribuon në NATO në mënyra të ndryshme. “Gjermania ndihmon vërtet në forcimin e Aleancës Transatlantike. NATO qëndron në solidaritet me aleatin tonë, Poloninë dhe aleatët e tjerë të prekur si Lituania dhe Letonia. Ne shohim gjithashtu një vendosje të konsiderueshme ushtarake nga Rusia pranë kufijve të Ukrainës dhe ne shohim një përqendrim të pazakontë të forcave dhe i bëjmë thirrje Rusisë që të jetë transparente dhe të parandalojë një përshkallëzim dhe të ndihmojë dhe të ulë tensionet përgjatë kufijve me Ukrainën”. Stoltenberg përmendi para medieve edhe sfidat e tjera si ngritjen e Kinës, por tha se “ne nuk e konsiderojmë Kinën si një kundërshtar, por duhet të adresojmë efektet e sigurisë të rritjes së Kinës”, -dhe përmendi gjithashtu sulmet kibernetike

si sfida të shpeshta dhe sfida të tjera. “E gjithë kjo e bën edhe më të rëndësishme që Evropa dhe Amerika e Veriut të qëndrojnë së bashku në NATO”. Por lidhur me se sa e rrezikshme është situata në kufirin Lindor dhe a po flitet me palët, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, u tha medieve se “duhet të bëjmë dallimin midis asaj që shohim përgjatë kufijve me Ukrainën ose Ukrainën dhe Rusinë dhe gjithashtu brenda Ukrainës, në Krime, dhe asaj që shohim në kufirin midis Polonisë dhe Bjellorusisë. Po monitorojmë dhe ndjekim nga afër situatën”. Ai tha se ndërkohë “aleatët e NATO-s, i ofrojmë mbështetje Ukrainës: ndërtim kapacitetsh, mbështetje politike”, dhe se që nga aneksimi i paligjshëm i Krimesë, “NATO ka zbatuar përforcimet më të mëdha të mbrojtjes sonë kolektive që nga fundi i Luftës së Ftohtë”, me rritjen e pranisë ushtarake në rajonin e Balltikut, Poloni. “Gjermania është pjesë e kësaj, -tha ai “duke udhëhequr një nga grupet e betejës në vendet baltike, në Lituanin dhe pastaj kemi edhe policimin ajror dhe kemi shtuar praninë tonë. Pra mesazhi ynë është se ne po dërgojmë një mesazh të qartë solidariteti, për nevojën për të bërë të qartë se ne respektojmë dhe të gjitha vendet duhet të respektojnë integritetin territorial dhe sovranitetin e Ukrainës. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, iu tha gazetarëve se aleatët e NATO-s qëndrojnë në solidaritet me Poloninë dhe gjithashtu me Lituaninë dhe Letoninë, dy aleatë të tjerë të NATO-s të prekur drejtpërdrejt nga një situatë e vështirë përgjatë kufijve. “Ne dërguam gjithashtu më herët këtë vjeshtë një ekip ekspertësh në Lituanin për t’i ndihmuar ata për t’i mbështetur. Ne jemi të gatshëm të ofrojmë mbështetje. Në të njëjtën kohë ne mirëpresim edhe përpjekjet e Gjermanisë për të gjetur një zgjidhje dhe kemi parë disa hapa në drejtimin e duhur. Ne kemi punuar gjithashtu me vendet partnere si Iraku dhe mirëpresim faktin që Iraku tani po merr njerëz dhe ka ndaluar fluturimet”. Por Stoltenberg tha se “ende kemi ende një situatë të vështirë, jemi të shqetësuar, por në të njëjtën kohë kemi parë disa lëvizje në drejtimin e duhur dhe sigurisht e mirëpresim këtë”.



"Skënderbegasit"

Në panteonin e vlerave të kombit shqiptar



"Do të varfërohej mjaft historia e sportit shqiptar nëse do t'i hiqej historia e Partizanit"

Ali Kastrati/ Nga fusha e blertë në ring, Partizani 'ylli' që shndrin

**Shefe e sektorit të Botimeve
Anjeza Musollari**

Skuadra e Partizanit e arriti objektivin e vet duke u përshkuar nëpër një përparim gradual dhe të sigurt. Loja e përfaqësuesve të tij në disiplina të ndryshme dhe fitoret e korrura ndër vite e bënë që të fitonte gjithnjë e më tepër forcë, vitalitet, stil dhe harmoni.

Skuadra ushtarake që në të njëjtën kohë ishte edhe skuadra shembullore e rregullit, e disiplinës, e vëllazërimit, erdhi në një formë të shkëlqyer.

Do të varfërohej mjaft historia e sportit shqiptar nëse do t'i hiqej historia e Partizanit, që nuk është vetëm një histori e madhe e futbollit. Është histori e atletikës së lehtë, e basketbollit, e volejbollit, e notit, e gjimnastikës, e qitjes, e peshëngritjes, e boksit, e mundjes... Prej ku përmbledhen tituj të panumërt të kampionit të Shqipërisë si ekip dhe qindra e qindra tituj të kampionëve vetjakë të Shqipërisë.

Ndodh që pa mbaruar kampionati i futbollit, papritmas shfaqet një Partizan tjetër, Partizani i boksit, i cili shpallet kampion i Shqipërisë, duke u bërë ky Partizani i parë që fiton si ekip një kampionat kombëtar të Shqipërisë. Madje, edhe me plot pesë tituj individualë në peshat përkatëse si, Myftar Marku, Ndrek Zefi, Mehmet Kryeziu, Naum Gjançi. Dhe tjetri, më i veçanti, është Ali Kastrati që shpallet kampion duke fituar ndaj legjendës shqiptare të boksit Rafail Dishnicës.

Ali Kastrati ka qenë 15 herë kampion

kombëtar në boks, 16 herë në mundje dhe 15 herë në peshëngritje si trajner. Fitues i të gjitha kupave të Republikës në mundje (1951-1966), boks (1951-1963) dhe në peshëngritje (1949-1966), si trajner me Partizanin.

- *Fitues i 3 medaljeve të arta si trajner në Spartakiadën e parë Kombëtare me Partizanin në të 3 sportet;*

- *Trajner i ekipeve kombëtare në boks, mundje e peshëngritje (1958, 1960 dhe 1963);*

- *Mban 65 medalje të kampionit kombëtar;*

- *Ka zhvilluar 20 takime ndërkombëtare dhe rreth 300 ndeshje si boksier;*

- *Është zgjedhur midis 12 sportistëve më të mëdhenj shqiptarë për të gjitha kohët (1998);*

- *Është nderuar me medaljonin "Nderi i Sportit Shqiptar";*

U nda nga jeta më 11 mars 2013.

Me një trup të lidhur dhe tepër elegant, me një pasion të lindur për sportet e rënda, Aliu e nisi rrugën e sportit në moshën 18 vjeçare, në vitin 1940. Një nga mësuesit e tij ishte Adem Karapici, i cili më pas u bë trajner i Partizanit dhe i Kombëtares në futboll. Si boksier, Ali Kastrati nisi aktivitetin në vitin 1940 në Tiranë, por famën ia japin ndeshjet me Mario Deniskën 1943, ish-kampion i Italisë e më tej me Hufs Jan kampion i Gjermanisë në 1944 dhe me Rafael Dishnicën, kampion i Shqipërisë në Tiranë (1947) në kampionatin e parë kombëtar të boksit të organizuar pas Çlirimit të vendit.

Pas sukseseve kombëtare do të vijnë edhe ato ndërkombëtare, madje me boksier

erë të famshëm: në Bullgari me Vladimir Kristof në 1949, në Poloni me Kolshinski në 1949, në Çekosllovakë me boksierin Tjurmen, po në 1949 apo në Hungari me dy nënkampionët e vendit. Kastrati ka realizuar mbi 200 ndeshje boks, ku ka dalë 4 herë Kampion Kombëtar (1947, 1948, 1950, 1951), ndërkohë që ka dalë edhe 14 herë si trajner boks me Partizanin (1947, 1948, 1950-1953, 1956-1963). I përgatitur mirë fizikisht, i fuqishëm, luftarak e me forcë të madhe grushtimi, Kastrati ka qenë shumë i suksesshëm se çdo boksier tjetër në Shqipëri.

Ali Kastrati e përfaqësoi 20 herë Shqipërinë në vende të ndryshme të botës, prej të cilave ai fitoi 18 herë. Ai ka marrë pjesë në Kampionatin Ballkanik në Rumani (1947), takimin ndërkombëtar Shqipëri-Bullgari (1948), në Lapcig të Gjermanisë me Partizanin (1958), në Bashkimin Sovjetik (Armeni, 1958), si dhe në takime ndërkombëtare kundër boksierëve hungarezë, gjermano-lindorë, koreano-veriorë dhe indonezianë. Mjeshtri i merituar i sportit ka nxjerrë një plejadë të shquar boksierësh. Në boks ai ka nxjerrë emra të tillë si Bejkush Birçe, Hysen Sharra, Ramiz Reka, Et'hem Ibrahim, Ismet Varfi, Gjergji Kasa, etj.

Ali Kastrati mbetet një nga figurat më emblematiche dhe më të mëdha të sportit tonë. Fitues anketash dhe i zgjedhur si një nga 12 sportistët më të mirë të të gjitha kohërave. Ali Kastrati njihej me shumë epitete: "Profesor", "Doktor", "Ai Baba", "Baba Aliu", kjo jo vetëm për shkak të moshës, por për atë që ka dhënë në sport dhe jashtë tij.

RAMIZ REKA:

Boksi ka qenë një sport me emocione të mëdha



Lindur më 17 janar 1938 në qytetin e Durrësit, 3 herë kampion me të rinjtë me Lokomotivën e Durrësit.

1957-1963 Përfaqëson Partizanin;

1958-1963 Anëtar i ekipit kombëtar të boksit;

1959-1963 Pesë herë kampion i Spartakiadës së përgjithshme të Ushtrisë;

1964-1965 Gjimnastikë artistike në Kat. I-rë me "17 Nëntorin";

1965-1968 Trajner i Gjimnastikës sportive të Partizanit.

Kuadër sporti

1968-1972 Mësues i edukimit fizik;

1972-1981 Pedagog i gjimnastikës në Institutin e Fizkulturës;

1981-1982 Pedagog në katedrën e Teorisë dhe Metodikës së përgjithshme të edukimit fizik;

1982-1987 Jep lëndën e gjimnastikës në shkollën e futbollit "Loro Boriçi";

1983-1984 Realizon kualifikimin pasuniversitar;

1987-1993 Pedagog i përgatitjes fizike speciale "Boks" pranë Akademisë së rendit;

1991-1992 Sekretar i përgjithshëm i Federatës së Boksit;

1987-1993 Pedagog i përgatitjes fizike speciale "Boks" pranë Akademisë së rendit;

1991-1992 Sekretar i përgjithshëm i Federatës së Boksit;

1991-2001 Kualifikim si gjyqtar i nivelit kombëtar;

2000-2009 Pedagog në Akademinë e Edukimit Fizik;

1992-2008 Drejtor teknik i FSHBo-së;

2002-2006 Anëtar i komisionit teknik të EABA-s;

Vlerësuar si:

-Mësues i dalluar i qytetit të Tiranës (1972);

-Personalitet i shquar i sportit nga Bashkia e Tiranës (2006);

-Medalja e Meritës në 70-vjetorin e klubit të Partizanit;

-Libri i Artë në 50-vjetorin e klubit të Partizanit;

-Medalja "25 vjet FSHBo" për kontributin si nismëtar për kthimin e boksit;

-Mban titullin "Mjeshtër Sporti" marrë në vitin 1960;

-Ka promovuar ekspozitën "Me dhe në shërbim të sportit".

I ardhur nga një familje me tradita sportive dhe me dashurinë për këtë disiplinë, që në moshën 10-vjeçare ai ka filluar të ushtrohet me rrethin e tij të shkollës apo dhe lagjes. Dhe në një nga grumbullimet që bënin ishte një trajner jugosllav ai që e zgjodhi. Në moshën 15-vjeçare erdhi titulli i parë, në përballje me V. Grudën, i cili nuk u paraqit në takim, si duket e kuptoi që nuk do t'ia dilte, dhe Ramiz Reka fitoi në tavolinë. Këto kanë qenë hapat e parë të tij në boks më pas do të vazhdonte si sportist me një tjetër dimension si pjesë e klubit të Partizanit, që ishte arritja më e madhe në atë kohë për një të ri ambicioz në sport, një klub i dashur dhe që mblidhte ajkën e sportistëve në të gjitha disiplinat, klub madhështor.

Ka qëndruar me klubin e kuq nga viti 1957 deri më 1963 kur u vendos të mbyllej boks. Koha kur u mbyll boks i gjeti si trajner të të rinjve të Partizanit,

Ramiz Reka: Boksi ka qenë një sport me emocione të mëdha, kishim mangësi të përgatitjes taktike, por nuk vihej në diskutim përkushtimi dhe morali i lartë i sportistëve tanë. Në atë periudhë boks luhej pa kaskë mbrojtëse. Ka pasur mjaft raste kur lindnin probleme me protezat, por rezultati i fitores na krijonte emocione të tilla që të mos ndienim asnjë dhimbje. Një ndër ndeshjet më të bukura, me të cilën mbylli edhe karrierën si boksier ringu, ishte ajo me Viktor Martinin, viti 1963, ku fitoi si 5-herë kampion i Ushtrisë. Ndeshja më e bukur ndërkombëtare që ka zhvilluar është ndaj Frederik Shulc, të Gjermanisë. Ndeshje e realizuar në Gustrov të Gjermanisë Lindore. "Në atë kohë formula ishte ndryshe nga sot. Për shembull, sot është me eliminim direkt, por në atë kohë kishte ndeshje në formë rrethi, ku secili boksier do të ballafaqohej me të tjerët. Fitonte vendin e parë ai që korrte më shumë fitore. Boksi nuk është thjesht forcë, duhet të dish si futesh në sulm dhe si të dalësh nga sulmi. Boksi kërkon përgatitje shumëplanëshe. Që kur u rikthye në vitin 1991, boks ka bërë hapa të mëdhenj përpara. Ndërrerja 28-vjeçare ka lënë gjurmë në nivelin tekniko-taktik, por përpjekjet për të bërë boks profesionist dhe shtimi i aktiviteteve dhe ndeshjeve ndërkombëtare do të sjellë përmirësim", -do të shprehej Ramiz Reka.

OLAF SCHOLZ, KANCELARI I RI

Për herë të parë pas 16 vitesh, Gjermania do të ketë një qeveri të qendrës së majtë

Për herë të parë pas 16 vitesh, Gjermania do të ketë një qeveri të qendrës së majtë dhe një Kancelar të ri. Olaf Scholz, kandidati Social-Demokrat, do të ketë më në fund zyrtarisht mundësinë të drejtojë vendin pas Angela Merkel, pas arritjes së marrëveshjes me partitë e tjera të koalicionit, që ishte i domosdoshëm për krijimin e qeverisë së re.

Diskutimet me Të Gjellbrit dhe Demokratët e Lirë kanë përfunduar dhe parashikohet që Scholz të bëjë betimin muajin e ardhshëm. Sipas "Bild" në negociatat që zgjatën për gati një muaj, morën pjesë rreth 300 politikanë.

Scholz do të marrë më në fund drejtimin e vetëm të qeverisë gjermane, pasi për 3 nga 4 mandatet e Merkel, ishte në koalicion me të. Ai do të përballet me krizën e koronavirusit, pasi Gjermania po regjistron rritje të rasteve çdo ditë e më shumë, por edhe kriza të tjera rajonale e globale, si ajo me emigrantët në Bjellorusi dhe konflikti mes Ukrainës e Rusisë.

Gjithashtu, Scholz do të duhet të tregojë se mund të administrojë agjendat e aleatëve në qeveri, sidomos të Demokratëve të Lirë, kryetari i të cilëve, Chrisitan Lindner, është një konservator fiskal i cili është shprehur gjithmonë kundër rritjes së taksave.



Shekerinska: Krenohemi me sukseset sepse janë rezultat i punës dhe i përkushtimit të vazhdueshëm dhe se e ardhmja jonë e afërt do të tregojë se jemi edhe më ambiciozë

Ministrja Radmilla Shekerinska mori pjesë në promovimin e 70 nënoficerëve të rinj, që u mbajt në kazermën "Ilinden" në Shkup. Duke iu drejtuar të pranishmëve, ajo përgëzoi nënoficerët dhe tha se ky është një tjetër proces i përfunduar me sukses i transformimit dhe përmirësimit të strukturës së Armatës.

"Kur erdha në detyrën e ministres së Mbrojtjes, një nga problemet që më vunë në dukje ishte se nuk kishte pasur asnjë kurs nënoficeri për një dekadë të tërë. Filluam menjëherë zgjidhjen e problemit hap pas hapi dhe rezultatet u bënë të dukshme në një kohë të shkurtër. Pavarësisht nga të gjitha sfidat e pandemisë, në dy raste kemi përgatitur 55 dhe 65 ose gjithsej 120 nënoficerë. Sfidat nuk u ndalën, por nuk ndaluam edhe ne. Kemi vazhduar me ju edhe këtë vit, që sot të kemi gjithsej 190 nënoficerë të rinj në gradat e ushtrisë", -tha ministrja.

Shekerinska theksoi se duhet të krenohemi me sukseset sepse janë rezultat i punës dhe përkushtimit të vazhdueshëm dhe e vuri në dukje integrimin ushtarak si një nga rezultatet që e forcoi edhe më tej pozitën e Maqedonisë së Veriut në NATO dhe në mesin e aleatëve, për çka morën vlerësime nga më të lartat.

"Këtë të martë komandanti i Komandës së Transformimit, një nga dy komandat strategjike të NATO-s, gjenerali Filip Lavinj, vizitoi Maqedoninë e Veriut. Gjatë bisedimeve ai përmendi faktin se Maqedonia e Veriut ka përfunduar procesin e integritetit të plotë ushtarak në NATO në një periudhë të shkurtër rekord, periudha më e shpejtë ndonjëherë në NATO", -tha ministrja, duke shtuar se për këtë proces vendeve fqinje u janë nevojitur 26, 43 dhe 55 muaj, ndërsa Maqedonia e Veriut e përfundoi procesin në 19 muaj nga anëtarësimi i plotë.

Shekerinska tha gjithashtu se imazhi i Armatës ka ndryshuar për katër vjet dhe se ambiciet për pajisje do të vazhdojnë. "Jam e bindur se e ardhmja jonë e afërt do të tregojë se jemi edhe më ambicioz. Ju dhe kolegët tuaj nga viti i ardhshëm do të filloni të merrni edhe transportuesit e rinj të blinduar, artileria do të marrë armë të reja ar-



tilerie, pjesëtarët e Mbrojtjes Ajrore do të kenë armë të reja për mbrojtjen ajrore, për pilotët tanë për vitin 2024 do të fillojmë me prokurimin e ri të helikopterëve. Dhe e gjithë kjo është e mundur vetëm sepse vitet e fundit, çdo vit arrijmë të sigurojmë fonde të qëndrueshme dhe të shtuara për mbrojtjen. Buxheti i mbrojtjes nga viti 2017 deri në këtë vit, duke përfshirë vitin 2022, po rritet çdo vit. "Kjo është rritja që çoi në të ardhurat tuaja më të larta dhe pajisjet tuaja më të mira, armët personale dhe elementët mbrojtës dhe gjithçka që e bën ushtrinë një institucion për të cilin jemi krenarë", -tha Shekerinska.

Në promovimin e sotëm të 70 nënoficerëve të rinj morën pjesë Shefi i Shtabit të Përgjithshëm Vasko Gjurchinovski, sekretari shtetëror Dragan Nikoliq dhe zyrtarë të lartë ushtarakë nga ushtria.



"Një komb mbahet gjallë po të ketë gjuhën e vet, ndryshe humbet, shuhet, vdes përjetë"

*Gjuha jonë sa e mirë!
Sa e ëmbël, sa e gjerë!
Sa e lehtë, sa e lirë!
Sa e bukur, sa e vlerë!*

113 vite identitet kombëtar!

22 nëntori i vitit 1908 shënohet si dita e Alfabetit të Gjuhës Shqipe, i cili u njësua në Kongresin e Manastirit. Kjo është festë që kremtohet brenda dhe jashtë viseve të Shqipërisë.

Data 22 nëntor përbën një ditë përkujtimore në Shqipëri, Kosovë, Republikën e Maqedonisë dhe në diasporën shqiptare, pasi kjo datë shënon ditën e Alfabetit të Gjuhës Shqipe. Alfabeti u njësua gjatë Kongresit të Manastirit i njohur ndryshe edhe si Kongresi i Alfabetit.

Mes datave 14 nëntor - 22 nëntor 1908 është mbajtur një konferencë akademike në qytetin e Manastirit, për standardizimin e alfabetit të gjuhës shqipe.

Përpara kongresit, gjuha shqipe përfaqësohej prej gjashtë ose më shumë alfabetesh, pa llogaritur nënvariantet. Kongresi u mbajt prej shoqërisë "Bashkimi" në shtëpinë e Fehim Zavalanit, ku ishte edhe selia e shoqërisë.

Pjesëmarrësit në kongres ishin figura të dalluara të jetës kulturore e politike mbarë shqiptare. U thirrën 50 delegatë, përfaqësues të njëzet e tre qyteteve të banuara nga shqiptarët, shoqërive kulturore e patriotike, tridhjetë e dy nga të cilët kishin të drejtë vote dhe tetëmbëdhjetë ishin vëzhgues.

Ndër delegatët më të shquar qenë Gjergj Fishta, Mit'hat Frashëri, Sotir Peci, Ndre Mjeda, Shahin Kolonja, Bajo Topulli, Parashqevi Qiriazi, Fehim Zavalani. Delegat tjetër nga familja Zavalani ishte Izet Zavalani, përfaqësues i Follorinës. I zoti i shtëpisë, Fehim Zavalani, mbajti fjalën hyrëse.

● Kongresi i Manastirit është padyshim një ndër ngjarjet më të mëdha historike dhe kulturore të shekullit të kaluar për mbarë popullin shqiptar, të cilit i janë referuar dhe i referohen vazhdimisht historianë, gjuhëtarë, etnologë, intelektualë shqiptarë dhe të huaj, duke synuar të hedhin dritë mbi rrethanat komplekse historike, politike dhe kulturore të periudhës së kaluar dhe të sjellin sa më shumë fakte për këtë ngjarje kaq të rëndësishme për mbarë popullin shqiptar.



Kongresi i Manastirit është padyshim një ndër ngjarjet më të mëdha historike dhe kulturore të shekullit të kaluar për mbarë popullin shqiptar, të cilit i janë referuar dhe i referohen vazhdimisht historianë, gjuhëtarë, etnologë, intelektualë shqiptarë dhe të huaj, duke synuar të hedhin dritë mbi rrethanat komplekse historike, politike dhe kulturore të periudhës së kaluar dhe të sjellin sa më shumë fakte për këtë ngjarje kaq të rëndësishme për mbarë popullin shqiptar.


"Rilindasit kombëtarë me shkronjat e Alfabetit shkruan histori emancipimi dhe kulturë të ndritur, jam e bindur se po me të njëjtat shkronja do mund të shkruajmë të ardhmen me vlerat që ata na kanë lënë testament!

Ne, sot, përulemi me nderimin më të madh për të gjithë aktorët e kësaj ngjarjeje kaq të madhe historike dhe me dinjitet e nderojmë ditën e Alfabetit shqip në përvjetorin e tij.

Gëzuar përvjetorin e shkronjave shqipe, gëzuar festat e nëntorit....

Anjeza Musollari,
Shefe e sektorit të Botimeve





Ministri Mehaj ka theksuar se Kosova dhe Letonia kanë histori të ngjashme dhe objektiva të ngjashëm për kontribut në paqen, sigurinë dhe stabilitetin kontinental dhe më gjerë. Gjithashtu, ai theksoi se të dy vendet kanë përcaktimin e njëjtë euroatlantik dhe se Kosova mund të mësojë shumë nga Letonia, sidomos në eksperiencën për anëtarësim në NATO.



Kryeministri Justin Trudeau

"Kanadaja do të vazhdojë të llojë për njohjen e Kosovës dhe anëtarësimin e saj në organizatat ndërkombëtare"

Kanadaja do të vazhdojë të llojë për njohjen e Kosovës dhe anëtarësimin e saj në organizatat ndërkombëtare", -ka thënë kryeministri kanadez, Justin Trudeau.

Këto deklarata ai i bëri në takim me presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani.

Sipas njoftimit të Zyrës së Kryeministrit kanadez, në këtë takim ata kanë biseduar për marrëdhëniet mes dy vendeve dhe çështjet aktuale globale.

Po ashtu, dy liderët kanë diskutuar për prioritetet e përbashkëta, duke përfshirë edhe fuqizimin e grave, mbrojtjen e mjedisit dhe ndryshimet klimatike, por edhe për sundimin e ligjit dhe demokracinë.

Ndërkaq, në njoftim thuhet se Osmani ka folur edhe për reformat e brendshme në Kosovë, me theks në iniciativat kundër korrupsionit dhe rritjen ekonomike si prioritetet e saj kryesore.



Letonia si vend i rëndësishëm i NATO-s, partneri ynë bilateral i radhës

Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka udhëtuar për vizitë zyrtare në Letoni. Përgjatë vizitës treditore, përveç takimit zyrtar me ministrin e Mbrojtjes së Letonisë, Artis Pabriks, ministri Mehaj do të takohet edhe me shefin e Mbrojtjes së Forcave të Armatosura Letoneze, gjeneralletjënant Leonids Kalniņš, si dhe autoritetet tjera të larta politike dhe ushtarake. Me homologun e tij, ministrin Pabriks, ministri Mehaj do të nënshkruajë edhe Memorandumin e Mirëkuptimit, respektivisht Marrëveshjen Bilaterale në mes ministrive të dy vendeve. Marrëveshja e bashkëpunimit tonë do të jetë një faqe e re e zhvillimit të kapaciteteve të ndërsjella ushtarake në funksion dhe shërbim të sigurisë dhe stabilitetit kontinental dhe më gjerë.



Nënshkruhet Marrëveshja e bashkëpunimit bilateral ushtarak mes Kosovës dhe Letonisë

Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj: Kosova mund të mësojë shumë nga Letonia, sidomos në eksperiencën për anëtarësim në NATO

Nënshkruhet Marrëveshja e bashkëpunimit bilateral ushtarak mes Kosovës dhe Letonisë. Gjatë vizitës zyrtare në Letoni, ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, së bashku me ministrin e Mbrojtjes së Letonisë, Artis Pabriks nënshkruan sot Memorandumin e Mirëkuptimit, respektivisht Marrëveshjen e Bashkëpunimit bilateral mes Kosovës dhe Letonisë, në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Ky Memorandum përcakton fushat e bashkëpunimit të dy shteteve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Të dy ministrat po ashtu bënë marrëveshje që të intensifikohet bashkëpunimi në mes të dy ministrive dhe forcave, me shkëmbim të personelit, në trajnime dhe stërvitje të përbashkëta, si dhe aktivitete të tjera, me interes të përbashkët.



Me këtë rast, ministri Mehaj ka theksuar se Kosova dhe Letonia kanë histori të ngjashme dhe objektiva të ngjashëm për kontribut në paqen, sigurinë dhe stabilitetin kontinental dhe më gjerë.

Gjithashtu, ai theksoi se të dy vendet kanë përcaktimin e njëjtë euroatlantik dhe se Kosova mund të mësojë shumë nga Letonia, sidomos në eksperiencën për anëtarësim në NATO.

Në aspektin e avancimit të bashkëpunimit, të dy ministrat janë dakorduar që në të ardhmen të nënshkruajnë edhe një sërë marrëveshjesh, të cilat do të konkretizojnë bashkëpunimin në fushat specifike.

10 marinat më të fuqishme në botë

Gazeta "Ushtria
do të botojë në
numrat e ardhshme
marinat më të
fuqishme në botë

Marina kineze, zyrtarisht Marina e Ushtrisë Çlirimtare Popullore, deri në fund të viteve 1980 ishte kryesisht një forcë lumore dhe bregdetare. Që nga fillimi i viteve 1990 Kina filloi zgjerimin e flotës së saj dhe aktualisht po ndërton anije të reja luftarake dhe nëndetëse me një ritëm të shpejtë. Marina kineze ka rreth 255,000 personel. Aktualisht është marina e dytë më e madhe pas Marinës amerikane për sa i përket tonazhit. Për më tepër, ajo ka numrin më të madh të anijeve luftarake kryesore. Deri në vitin 2018, marina kineze drejtonte një aeroplanmbajtëse të vetme "Liaoning", e cila përdoret kryesisht si anije stërvitore. Sidoqoftë, një transportues i ngjashëm, Shandong, u autorizua në vitin 2019.

Marina Kineze ka rreth 30 shkatërrues, 50 fregata dhe 40 korveta. Megjithatë disa nga anijet luftarake më të vjetra nuk janë aq të afta sa homologet e tyre perëndimore apo edhe ruse. Nga ana tjetër, anije të reja luftarake të përparura po ndërtohen me një ritëm jashtëzakonisht të shpejtë. Për më tepër, rreth 5-6 kryqëzore të raketave të drejtuara të klasit "Type 055" janë drejt përfundimit dhe duhet të funksionojnë në vitin 2020.

Forcat sulmuese amfibe kineze operojnë me 4 doke transporti amfib, 32 anije zbarkimi tankesh dhe 31 anije zbarkuese të mesme. Marina kineze ka 10 000 marinsa që mund të zbarkojnë në brigjet armiqësore.

Marina kineze operon një flotë prej 68 nëndetësesh. Prej këtyre janë 4 nëndetëse të raketave balistike me fuqi bërthamore të klasit "Jin", që mbajnë raketa balistike ndërkontinentale me majë bërthamore. Megjithatë deri më tani këto nëndetëse raketore nuk kanë kryer

ndonjë patrullim parandalues operacional, ndoshta për shkak të problemeve të ndryshme dhe të metave të projektimit, edhe pse këto anije të raketave balistike kanë probabilitet të lartë për të mbijetuar me goditjen e parë, pas një sulmi të mundshëm. Gjithashtu ka 2 nëndetëse sulmuese aktive të klasit

"Shang", një nëndetëse sulmi me motor naftë të klasit "Qing", nëndetëse patrullimi me motor naftë të klasit "15 Yuan", si dhe 13 nëndetëse patrullimi me motor naftë të klasit "Song".

Marina kineze operon gjithashtu më shumë se 700 avionë, ku mbi 140 prej tyre janë shumë-funksionalë.

Aviacioni detar kinez operon gjithashtu një numër të konsiderueshëm avionësh sulmues detarë JH-7 dhe mbi 30 bombardues me rreze të mesme H-6. Këto kanë për qëllim përfshirjen e grupeve luftarake të transportuesve amerikanë. Misioni kryesor i aviacionit detar është të sigurojë mbrojtje ajrore për flotën.



Marina kineze



Prof. Asoc. Dr. Zaho Golemi
Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj
Prof. Dr. Shyqyri Hysi

Nderimi për të rënë është një detyrim brezash, sepse dëshmorët i bënë të pavdekshëm dhe të shenjtëruar kujtimi dhe nderimi. Ata jetojnë dhe lartësohen në valët e flamurit dhe në kujtesën e gjithë shqiptarëve. Dëshmorët nuk vdesin, kur gjakun e derdhin për Atdheun dhe për flamurin kombëtar. Mirjan Hoxha ishte 20 vjeç, kur tranzicioni shqiptar dhe ndërrimi i sistemeve e gjeti ushtar dhe më tej polic në shërbim të shtetit në detyrën fisnike të ruajtjes së kufijve, por edhe të rendit, sigurisë e qetësisë në kryeqytetin e trazuar shqiptar të asaj kohe. Kërcënimi i situatës së brendshme vinte nga vetë shqiptarët dhe ishte sa i ashpër e brutal aq edhe i paarsyeshëm dhe i palogjikshëm. Detyra e policisë nuk ka ndryshuar. Mirjan Hoxha ishte në kohën dhe vendin e duhur, por forcat e errëta në Shqipëri hakmerreshin me cilindo, edhe me ushtarin-polic që i ruante. Mirjani kishte shkuar më parë si ushtar-polic në repartin nr. 425 në Korçë dhe më pas në repartin nr. 712 në Tiranë, ku shërbimin e kryente pranë ambasadave të huaja. Ka qenë data 20. 04. 1991, ndërkohë që ishte në krye të detyrës përpara ambasadës polake në Tiranë, është vrarë pabesisht nga një grup i armatosur. Kanë kaluar tre dekada që kur ka rënë për rendin e qetësinë në Shqipëri. Jeta e tij u këput në mes nga forca të errëta duke ngelur memorial kujtimi dhe dëshmor i pashpallur, por familjarët janë në pritje që e drejta e gjakut të derdhur të policit, që ishte gjak i shtetit të vihet në vend. Ishte koha kur ndërronte sistemi, por bijtë e bijat e tij të ndara në kampe pluraliste kishin humbur busullën e orientimit të shqiptarizms. Opozitarizmi ishte keqkuptuar e keqinterpretuar. Gjaku i derdhur i policisë, gjaku i 267 bijve e bijave më të mirë të policisë vetëm në 30 vjet është i pajustificuar për një vend që kërkon zhvillim dhe të ketë prosperitet me synime të qarta për një shtet të së drejtës, ku të ketë rend e qetësi, siguri për komunitetin.

E kishte pritur me kënaqësi ditën e betimit, sepse Ai vinte nga një trevë mençurie, që kishte përkundur në djepe burra të pushkës dhe të penës, të mençurisë dhe të trimërisë. Mirjani ishte burrëruar para kohe, ishte serioz, punëtor dhe i përkushtuar para vështirësive. Kur e përcollën në detyrë e llogaritën në “radhën e burrave” siç e donte zakoni dhe përcjellja ishte një moment i veçantë jo vetëm në familje por edhe për fshatin e tij Levanin dhe krahinën. Pas mobilizimit dhe kryerjes së karantinës i vinte radha betimit. Ai e dinte se, shqiptarët ishin betuar që herët nëpër breza, për pushkë, për këtë tokë, për flamur, për nënën dhe babën, për truallin e të parëve, për atdheun që e kishin pasur amanet brezash edhe në kohët e pushtimeve më të egra. Edhe Mirjani dhe shokët e tij e pritën betimin si zakon brezash, si një traditë të të parëve që betoheshin shekujve dhe krijonin një atmosferë solemne, që finalizohej me puthjen e flamurit dhe nënshkrimin e tekstit të betimit. Edhe në betimin ushtarak të Mirjan Hoxhës atmosfera ishte solemne, sepse atje kishin ardhur autoritete të larta, dhe vendi i betimit ishte një vend i shenjtë si monument i lavdisë së brezave. Pas betimit ushtari, polici, ushtaraku, djemtë nën uniformë në të gjithë nivelet nuk i

Mirjan Hoxha ushtari-polic, dëshmor për rend dhe qetësi në Shqipëri

● *(Kushtuar Dëshmorit të Ushtrisë dhe Policisë së Shtetit, Mirjan Dino Hoxha në 30 vjetorin e tij të rënies. Mirjan Hoxha ishte lindur më 21.1.1971 dhe ka rënë në mbrojtje të rendit dhe qetësisë publike më 20.4.1991, përpara ambasadës polake në Tiranë. Ushtari polic Mirjan Hoxha ishte nga Levani i Tepelenës dhe kishte shërbyer në Korçë e më tej në Tiranë. Fakt është se edhe pse plotëson tërësisht të gjitha kushtet e kriteret ligjore ish-polici Mirjan Hoxha ende nuk është shpallur dëshmor ashtu sikurse e kërkon ligji i shtetit shqiptar. Bazuar në ligjin nr. 109/2018, “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”, në nenin 5, “Kriteret për shpalljen e statusit “Dëshmor i atdheut”, pika “j” thotë që: Shpallen Dëshmorë të Atdheut “shtetasit shqiptarë, të cilët vriten nga elementë kriminalë për shkak të detyrës shtetërore që kanë kryer, në luftë kundër krimit dhe përpjekjeve për vendosjen e rendit dhe të qetësisë publike”. Nisur nga të dhënat e vrasjes në krye të detyrës, në përpjekje për vendosjen e rendit dhe të qetësisë publike, ish-ushtari polic Mirjan Hoxha rënë në krye të detyrës, me dokumente plotësisht të vërtetueshme meriton dhënien e statusit “Dëshmor i atdheut” nga Komisioni Qendror i Statusit të Dëshmorit të Atdheut).*

përkisnin më familjes por në radhë të parë shtetit, Atdheut, kombit. Teksti i betimit, uniformat, armët, marshet orkestrale ushtarake, himni, besimi në mbajtjen e armëve, flamuri i njësisë, parada ishin elementë që Mirjani regjistroi në kujtesë sikurse përsëriti fjalë pas fjalë formulën e betimit ushtarak. Kishte kaluar me bindje testet dhe udhëzimet e pjekurisë për detyrimet ndaj Atdheut. Mirjani dhe shokët e tij çdo ushtar-polic, morën përgjegjësi të rëndësishme që nga momenti i betimit. Ishte momenti kur zyrtarisht bëhej mbrojtësi i vendit të tij, mbrojtës i kufirit dhe më tej mbrojtës i rendit dhe qetësisë publike. Ai e njihte mirë ligjin dhe ishte ndërgjegjësuar për shkeljet sado të vogla të detyrimeve që çonin në dëmtimin e gatishmërisë, interesave të vendit dhe popullit, prandaj betimi i tij ishte betim me zemër: “Beto hem se do t’i shërbej me besnikëri Republikës së Shqipërisë; do të jem ushtar besnik i popullit tim, luftëtar i denjë, trim e i disiplinuar, do të jem i gatshëm në çdo kohë e vend dhe nuk do të kursej as jetën time për mbrojtjen e interesave të Atdheut. Beto hem!” Dhe në fakt nuk e kurseu jetën dhe gjakun e tij kur u bë barrikadë e drejtësisë dhe mbrojtjes së jetës qytetare më 20 prillin e vitit 1991, duke ngelur në kujtesën e familjes, fshatit Levan, Krahësit të Tepelenës dhe të të gjithë brezave të Policisë së Shtetit shqiptar.

Dëshmori që gjakun e fali për sigurinë e shtetit, Mirjan Dino Hoxha

Dëshirat dhe ambiciet ishin të shumta por detyra ndaj shtetit ishte detyrim për të gjithë djemtë shqiptarë. Me fletëthirrje nga autoritetet ushtarake të kohës, Qen-

drës së Rekrutim – Mobilizimit Tepelenë, Mirjani u thirr ushtar më 4 qershor 1990. Ai shkoj ushtar pranë Repartit Ushtarak Nr. 425 në Korçë, që është edhe e konfirmuar nga Qendra e Rekrutim Mobilizimit të Qarkut Gjirokastrës. Pasi kishte bërë karantinën ndërkohë që situata në Tiranë ishte e trazuar dhe nuk po gjente qetësi si rezultat i ndërrimit të sistemit socialist në sistemin demokratik një pjesë e kontingjentit të Korçës transferohen në Tiranë, për të përforcuar sektorin e ruajtjes, qetësisë dhe rendit publik. Kështu, duke qenë repart në varësi të Ministrisë së Brendshme pati edhe rishikim të shpejtë të shpërndarjes së forcave të rendit e sigurisë në vend dhe për nevoja emergjente shumica e policëve të repartit të Korçës ku shërbente Mirjani u transferuan pranë repartit nr. 712 Tiranë. Fakt është se për prezencën e policit Mirjan Hoxha në Repartin nr. 712 të Tiranës konfirmohet edhe nga një shkresë e lëshuar nga ky repart, më datë 30 mars të vitit 1991, vetëm pak ditë para se të vritej polici Mirjan Hoxha. Shkresa ishte lëshuar si vërtetim për të marrë pjesë në zgjedhjet e para pluraliste shqiptare të datës 30 mars 1991. Gjatë kryerjes së shërbimit policor pranë Ambasadës Polake, më 19 prill 1991 është plagosur rëndë dhe menjëherë ishte dërguar në Spitalin Ushtarak, Tiranë, ku nga të dhënat dokumentare, ka mbijetuar vetëm një ditë sepse ka ndërruar jetë nga plagët e rënda që kishte marrë, më datë 20 prill 1991. Kjo konfirmohet nga dokumentacioni: “...polici Mirjan Dino Hoxha ishte shtruar më datë 19.04.1991 dhe ndërroi jetë, datë 20.04.1991”. Mirjani u vra qëllimisht nga një grup prej tre vetash që ishin iniciatorë dhe në krye të një turme protestuesish të dhunshëm,

të cilët synonin destabilizimin e vendit. Në kohë të ndryshme në këtë situatë po në të njëjtën periudhë janë vrarë tre policë, dy prej të cilëve janë shpallur dëshmorë me arsyen se kanë vdekur menjëherë nga plagët e plumbave, ndërsa Mirjani ka ndërruar jetë në spital, po nga plumbat, por 24 orë më vonë. Në një dokument vërtetues të lëshuar nga QRM Gjirokastrë, që mban datën 16. 02. 2005 thuhet në mënyrë tekstuale se: “ Mirjan Hoxha....është vrarë nga një grup prej tre vetash”. Ishte pikërisht kjo ngjarje që është etiketuar si “ngjarja e ambasadave”, në prill 1991, që bëri që Mirjan Dino Hoxha të humbasë jetën në krye të detyrës duke lënë në pikëllim familjarët si dhe kolegët e tij të Policisë së Shtetit. Në kujtesën e brezit të tij ka ngelur momenti kur Ministria e Rendit, me urdhër të Ministrit të Rendit dhe qetësisë publike, organizoi ceremoninë e varrimit të ushtarit polic Mirjan Dino Hoxha. Në një kohë tejet të trazuar prindërit e dëshmorit polic (babai i tij Dino Hoxha) nuk pranon, që i biri Mirjani të varroset në varrezat e dëshmorëve, por në gjaknxehtësi e sipër, duke gjykuar se “djalin ja kisha besuar shtetit dhe për detyrën e detyrimin ndaj shtetit”, por jo t’ia kthenin të vdekur. Kohët ndryshojnë, por një gjë është fakt dhe e vërtetë se familja e Mirjan Hoxhës parapëlqeu që ceremonia e përcjelljes të bëhej më datë 21.4.1991, ora 18.30 në fshatin Levan të Tepelenës, atje ku ishin gjithë familjarët dhe të dashurit. Për kohën komplekse që kalonte vendi, familjarët e deshën birin e tyre pranë në varrezat e fshatit, por nderi i titullit “Dëshmor”, kërkon respektim të ligjit të shtetit. Shteti i kohës ishte dorëzuar

dhe në ceremoninë e varrimit të policit Mirjan Dino Hoxha mori pjesë Kompania e IV-të e Repartit Nr. 712, nën drejtimin e ushtarakut Sefer Pasha të Repartit nr.712. Ushtarakët dhe policët që morën pjesë në këtë ceremoni kanë lënë edhe një shkresë të firmosur prej tyre për një shumë monetare të përcaktuar për familjen e të ndjerit, e policit të Levanit, e dëshmorit të Shqipërisë, të rendit dhe të qetësisë publike. Nëse shikojmë listën e pjesëmarrësve që me lot në sy përcollën një ndër djemtë dhe shokët e tyre më të mirë. Ata nuk përcollën Mirjanin por një copëz të zemrës së tyre prandaj edhe familjarët e Mirjan Hoxhës nuk i harrojnë të 44 pjesëmarrësit që iu gjendën pranë në ditë gjëme për familjen e tyre siç janë: Frederik Nakolli, Nexhip Rexha, Arjan Jaupi, Kozma Qirja, Aleksandër Doshi, Nesim Cenaj, Adi Lule, Hekuran Xyra, Besnik Shkurti, Gazment Cani, Bekim Radaku, Ferdinand Laze, Ajan Delli, Ded Rroku, Sadik Ballhysa, Besnik Sulollari, Fatos Kiptiri, Ylber Pepa, Sokol Enia, Enver Sehti, Agim Ballaxhia, Arben Biraku, Bujar Leka, Adrian Ivanaj, Mentor Varosi, Kujtim Istrefi, Granit Bekollari, Rushit Belishahu, Besim Sala, Ded Peraj, Gëzim Moçka, Arben Myrto, Vilson Sulejmani, Bujar Brahushi, Arjan Ferroku, Fatmir Lame, Gëzim Nika, Adi Çipi, Pëllumb Ndreka, Mane Sula, Ilirjan Bakiasi, Partizan Petriti, Lefter Domi, Fatos Mema, Agron Paja, Ferdinand Preka dhe Genc Koka.

Këta bij nënash të përballur me rrezikun lanë një pjesë të zemrës në fshatin e shokut të tyre dëshmor të pashpallur, për paqëndrueshmërinë e strukturave të shtetit të asaj kohe. Megjithëse populli ka një maksimë proverbiale, që “e drejta zhytet por nuk mbytet”. Gjaku i shokut të tij polic, pjesë e strukturave të Policisë së Shtetit nuk harrohet, por meriton të jetë në piedestal të lavdisë dhe nderimit të kombit.

Nderim dhe vlerësim në përjetësi për dëshmorët e rënë për Atdhe

Biri i Levanit ishte punonjës shembullor i Policisë së Shtetit. Për djalin e policisë, për dëshmorin e orëve të para është folur dhe do të flitet, është nderuar dhe janë bërë homazhe duke nderuar përjetësisht yjet pranë Ministrisë së Brendshme, ku çdo yll përfaqëson një dëshmor. Po polici dëshmor Mirjan Hoxha ku e ka vallë yllin dhe a i janë bërë nderimet e plota sikurse gjithë dëshmorët e tjerë. Nderimi i dëshmorëve është një amanet brezash. Aktualisht ish-ushtaraku Sefer Pasha është duke shkruar një libër të posaçëm pikërisht për dëshmorin polic Mirjan Hoxha.

Forcat e Armatosura dhe mjetet e tyre të rënda po vazhdojnë punën në pika të ndryshme të vendit për heqjen dhe pastrimin e grumbujve të mbeturinave jashtë vendgrumbullimeve të caktuara

---SHQIPËRI E PASTËR---

